



UNIVERSITETI "ALEKSANDER MOISIU" DURRES
FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE
MASTER PROFESIONAL: PROFILI "DREJTIM TURIZMI"



TEMA

VLERESIMI TURISTIK I POTENCIALIT NATYROR DHE KULTUROR TE RRETHIT

DIBER

DEKANI

Prof.Dr.Elmas Leci

UDHEHEQESI

Dr.Moisi Kamberi


DIPLOMANTI

Miranda Çiku

Durres,2013

ABSCTRACT

Increased tourist movement and the development of new forms of tourism have made it necessary to use tourism as an effective tool for economic growth and development of a place. Tourism is a factor of profound changes not only in economics but also in social and cultural organizational of a region. The purpose of this topic is to provide opportunities offered by Dibra landscape, history and culture for tourism development in region. Throughout theoretical aspects and analysis the main forms of tourist movement in the region are indicated. In this paper will show that Dibra has potential to develop tourism and even turn into a genuiney touristic destination. This work also discusses ways that will assist in the formation of Dibra's image as a cultural touristic destination. The heritage (material and spiritual), the natural potential and improvement of tourist infrastructure are elements that will attract the attention of foreigners but also locals to visit Dibra. White tourism, ecotourism, agritourism, cultural tourism, mountain tourism and adventure are forms of tourist movement in Dibra. The development of the opportunities in the region will position Dibra in its rightful place in the Albanian tourism. The central and the local goverment are the main actors of the development of the tourism in the region.



Rritja e lëvizjes turistike si dhe zhvillimi i formave të reja të turizmit kanë bërë të domosdoshëm përdorimin e turizmit si një mjet efektiv për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Turizmi është faktor ndryshimesh të thella jo vetëm në ekonomi por edhe në organizimin social e kulturor të një rajoni. Qëllimi i kësaj teme është që të japë mundësi që ofron Dibra me relievin, historinë dhe kulturën për zhvillimin e turizmit në rajon. Nëpërmjet aspekteve teorike dhe analizës tregohen format kryesore të lëvizjes turistike në rajon. Në këtë punim do të tregojmë se Dibra ka potencialin e duhur për të zhvilluar turizmin dhe madje të kthehet në një destinacion të mirëfilltë turistik. Punimi gjithashtu shtjellon mënyra të cilat do të ndihmonin në formimin e imazhit të Dibrës si një destinacion turistik. Trashëgimia kulturore (materiale dhe shpirtërore), potenciali natyror dhe përmirësimi i infrastrukturës turistike janë elementet që do të tërheqin vëmendjen e të huajve por edhe vendasve për të vizituar Dibrën. Turizmi i bardhë, ekoturizmi, agroturizmi, turizmi kulturor, turizmi malor dhe ai i aventurës janë format e lëvizjes turistike me mundësi zhvillimi në rajon. Në këtë mënyrë Dibra do të zëjë vendin që i takon në turizmin shqiptar. Qeverisja qendrore dhe vendore janë aktoret kryesore të zhvillimit të turizmit.

FJAL

ËT KYQE turistik , produkt turistik , strategji turizmi , destinacion

MIR ËNJOHJE


Një mirënjohje shkon për UAMD-n që krijoi mundësinë për të studiuar në këtë profil

.Falenderim dhe mirënjohje për lektorët e kurseve që u zhvilluan në Masterin Profesional "Drejtim Turizmi".Mirënjohje gjithashtu për të gjithë anëtarët e grupit dhe një falenderim i vecantë për pedagogun udhëheqës Dr. Moisi Kamberi , i cili më ka dhënë një ndihmesë të madhe në përgatitjen e temës së diplomës.

Mirënjohje dhe falenderim per familjen time për mbështetjen e madhe që më ka dhënë gjatë studimeve të mia.

Falenderim i vecantë për vajzën time Sara që megjithëse e vogël arriti të kuptojë rëndësinë e studimeve të mia.

HJRJA	fq. 5
Kreu 1 : Pamje e përgjithshme e turizmit shqipëtar	fq. 8
Kreu 2 : Vlerësimi i potencialeve turistike të Dibrës	fq. 13
2.1 : Oferta gjeografiko-natyrore	
2.2 : Oferta gjeografiko-kulturore	
2.3 : Elementët dytësorë në studimin gjeografik të turizmit	
Kreu 3 : Lëvizja aktuale turistike	fq. 34
Kreu 4 : Llojet e turizmit që mund të aplikohen	fq. 35
Kreu 5 :Përmirësimi i produktit turistik	fq. 37
Përfundime	fq. 43
Rekomandime	fq. 44
Bibliografia	fq. 45



SHKURTESAT E P

ËRDORURA

UNWTO -> (United Nations World Tourism Organisation)

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Turizmin Botëror

QIT ->Qendër Informacioni Turistik

HYRJE

Turizmi është një prej industrive me sukses të madh kudo në botë. Ai tashmë është kthyer në formën kryesore të zhvillimit ekonomik në shumë vende anembanë globit. Natyra me format e saj të larmishm dhe trashëgimia kulturore me mozaikun e saj janë gjeneratorët e turizmit. Nëpërmjet eksperiencës dhe kënaqësisë që buron prej kontaktit me natyrën, artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore (materiale dhe shpirtërore) të vendeve pritëse turizmi shndërrohet në një mekanizëm gjenerues të natyrshëm të shkëmbimit të kulturave dhe të marrëdhënieve midis njerëzve të të gjitha moshave, besimeve dhe racave, në mënyrë shumë më tërheqëse sa format mekanike të tregtisë globale dhe ato të zhvillimit ekonomik. Tregjet turistike po bëhen gjithmonë e më shumë konkurruese me implementimin e llojeve dhe formave të shumëllojshme të lëvizjes turistike. Tashmë format tradicionale të saj po zëvendësohen me forma të reja, duke i dhënë një shtrirje mbarebotërore dhe heqjen e monopolit turistik rajoneve të ngrohta bregdetare dhe vendeve të zhvilluara ekonomikisht.

Kreu 1 : Pamje e përgjithshme e turizmit shqipëtar.

Në kreun 1 jepen të dhëna mbi pritshmëritë e lëvizjes turistike në Shqipëri. Këto pritshmëri bazohen në trendet e reja të lëvizjes turistike në botë dhe potencialet turistike që Shqipëria ofron

Kreu 2 : Vlerësimi i potencialeve turistike të Dibrës

Në kreun 2 merren në analizë oferta gjeografiko-turistike, kulturore si elementë parësor për zhvillimin e turizmit. Gjithashtu bëhet një analizë e sektorit të shërbimeve si pjesë e rëndësishme e lëvizjes turistike.

Kreu 3: Lëvizja aktuale turistike në Dibër


Në kreun 3 jepet një panoramë e përgjithshme e lëvizjes turistike në rajon ku evidentohet një numër në rritje i të huajve të interesuar të vizitojnë Dibrën

Kreu 4: Llojet e turizmit që mund të aplikohen

Në kreun 4 trajtohen format e lëvizjes turistike që mund të zhillohen aktualisht dhe në të ardhmen duke u bazuar në pasuritë natyrore dhe kulturore të rrethit.

Kreu 5: Përmirësimi i produktit turistik

Në kreun 5 jepen disa mënyra të cilat do të krijojnë standarte më të larta të imazhit turistik që Dibra të prezantohet sic duhet në tregun turistik.



Qëllimi i kësaj teme është që të jepet një panoramë e potencialeve turistike të rrethit të Dibrës. Përmjet analizës dhe aspekteve teorike tregohet se si Dibra mund të aplikojë turizmin si një tjetër formë e zhvillimit ekonomik të saj. Turizmi në Dibër mund të zhvillohet me përfitime të dyanshme. Turistët nga njëra anë përfitojnë përvoja të këndshme në të gjitha aktivitetet e tyre, ndërsa nga ana tjetër, turizmi në Dibër sjell rritjen e të ardhurave. Në këtë punim do të tregojmë gjendjen akyuale të zhvillimit të sektorit të turizmit, mangësive që pengojnë zhvillimin e tij dhe mundësive që mund të shfrytëzohen në të ardhmen. Gjendja e mjedisit natyror dhe pasurive kulturore të rajonit si dhe evidentimi i atyre më pak të dukshme është një tjetër aspekt i trajtuar. Dhënia e disa mendimeve të cilat do të mund të përmirësonin sektorin turistik është një tjetër aspekt që ka për qëllim të japë kjo temë.

Nga ky punim synohet të arrihen këto objektiva :

- Vlerësimi turistik i potencialit natyror dhe kulturor të rajonit.
- Ndërgjegjësimi i organeve qendrore dhe njësive vendore mbi rëndësinë që ka zhvillimi i turizmit.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit si hap drejt zhvillimit turistik.
- Krijimi dhe përmirësimi i kapaciteteve pritëse turistike në rajon .
- Përfshirja e biznesit në menaxhimin dhe zhvillimin e resurseve turistike.

METODOLOGJIA

Metodologjia për realizimin e këtij punimi është bazuar në përdorimin e metodave si hulumtimit, metodës së vrojtimit, analizës, metodes krahasuese etj. Informacionet dhe të dhënat janë siguruar nga burime të ndryshme informative si botime në fushën e turizmit, zyra e turizmit Peshkopi, agjensi turistike, MTKRS, ALCDF-ja etj

Si burim sekondar janë përdorur të dhëna të marra nga studime të mëparshme për rajonin e Dibrës.

Shqipëria është një vend shumë atraktiv me një ofertë turistike shumë komplekse. Paketat e ofertës variojnë nga natyra e saj e paprekur, deri në aspektet kulturore, kulinare, malet, lumenjtë,parqet,vendet e skive, folku, harmonia fetare dhe sigurisht një nga asetet më të mëdha janë njerëzit.Kombinimi i të gjithë këtyre komponentëve jep një produkt unik me vlerë të lartë i cili fatkeqësisht nuk promovohet sic duhet.Eshtë shumë e rrallë të gjesh një vend kaq të vogël në sipërfaqe me varietet të natyrës ku në pak orë ke mundësi të vizitosh malet, pyjet dhe detet. Ndryshimet e shpeshta te panoramës i bëjnë vizitorët të përjetojnë vecantinë e produkteve.Rritja e shpejtë e Turizmit ndërkombëtar drejt turizmit të aventurës,ekoturizmit,turizmit të përgjegjshëm,atij kulturor dhe eksperiencave personale unike janë mundësi dhe përgjegjësi të tjera për Shqipërinë për të hartuar oferta të përshtatshme me qëllim që të japin një version më atraktiv të të gjitha llojeve të turizmit. Shqipëria ka potenciale të mëdha për zhvillimin e të gjithë formave të turizmit dhe së bashku me një promovim më të mirë, plane investimi dhe burime njerëzore do ta arrijmë që turistët të mësojnë të vërtetën e këndëshme të pathënë për vendin tonë. Turizmi mund të ketë peshën e duhur në ekonomi duke bërë një rritje të balancuar të të gjithë sektorëve të ekonomisë.

INDUSTRIA E UDHËTIMEVE DHE TURIZMIT – NDIKIMI NË EKONOMI

Udhëtimet dhe Turizmi përfshirë transportin, akomodimin, kateringun, dhe shërbime të tjera për vizitorët janë nga industritë më të mëdha në botë me një përqindje rritje shumë të madhe të punëdhënësve dhe të punësuarve.Sipas një Raporti të Këshillit Botëror të Udhëtimeve dhe Turizmit të publikuar në 2009, Industria e Udhëtimeve dhe Turizmit në Shqipëri prezantohet me shifrat e mëposhtme:

Shqiperia	2009			2019		
	Al Lek bn.	% of Tot.	Rritja	Al.Lek bn.	% of Tot	Rritja
Turizmi dhe Udhëtimet Individuale	101.6	10.9	6.3	220.3	11.2	4.9
Udhëtimet e Biznesit	26.0	2.3	-1.9	54.4	2.3	4.5

Shpenzimet Qeveritare	5.3	3.8	18.3	11.2	4.0	4.6
Investimet Kapitale	29.3	7.0	-2.8	62.2	7.1	4.7
Eksportet e vizitoreve	96.1	36.4	-3.4	206.7	31.5	4.8
Eksporte te tjere	1.7	0.6	10.6	5.1	0.8	8.6
Kerkesa per Udhetime dhe Turizem	260.1	15.9	0.9	560.0	16.0	4.8
Industria e T&U dhe PBB	41.2	3.7	-4.5	88.0	3.8	4.7

Ekonomia e T&U PBB	140.2	12.5	-3.7	300.0	12.9	4.8
Punesimi ne Industrine e T&U	36.7	3.0	-5.2	43.2	3.0	1.6
Punesimi ne Ekonomine e T&U	125.8	10.1	-4.4	148.2	10.4	1.7

Tabela 1: Turizmi dhe Udhëtimet ne Shqipëri dhe ndikimet e tyre ne ekonomi

Raporti thekson faktet e mëposhtme

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)

Shqipëria – Industria e Udhëtimeve dhe Turizmit pritet të kontribuojë në mënyrë direkte me 3.7% në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) në 2009 (ALL41.2 mld ose US\$445.1 mln), duke u rritur në terma nominale me ALL88.0 mld ose US\$748.4 mln (3.8% e totalit) në 2019.

Kontributi i ekonomik i Udhëtimeve dhe Turizmit duhet të rritet nga 12.5% (ALL140.2 mld ose US\$1,514.3 mln) në 12.9% (ALL300.0 mld ose US\$2,550.5 mln) në të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Ne Bote - Në 2009, pritet që Industria e Udhëtimeve dhe Turizmit të kontribuojë US\$7,339,990 mln në aktivitetin ekonomik (Kërkesa Totale)dhe parashikohet të rritet në US\$14,381,500 mln deri në 2019.

Kerkesa

Shqipëria - Ne 2009, Udhëtimet dhe Turizmi pritet të kontribuojë ALL260.1 mld (US\$2,808.4 mln) e aktivitetit ekonomik (Kërkesa Totale), dhe rritet në ALL560.0 mld (US\$4,761.3 mln) në 2019.

Ne Bote - Ne 2009, Industria e Udhëtimeve dhe Turizmit duhet të kontribuojë me 3.2% direkt në PBB. Më gjerë Ekonomia e Udhëtimeve dhe Turizmit duhet të kontribuojë me 9.4% në PBB botërore në 2009.

Rritja

Shqipëria – Eksportet përbëjnë një pjesë shumë të rëndësishme të kontributit të Udhëtimeve dhe Turizmit në PB

Ne Bote – Udhëtimet dhe Turizmi janë aktivitete me rritje të lartë, me një parashikim të rritjes së aktivitetit të përgjithshëm ekonomik me 4% në rang botëror, në terma reale, në dhjetë vitet e ardhme.

Eksporti i Vizitoreve

Albania – Ekonomia e Udhëtimeve dhe Turizmit pritet të rritet me 4.8% në vit në terma reale ndërmjet 2010 dhe 2019. Nga të gjithë eksportet shqiptare Udhëtimet dhe Turizmi pritet të gjenerojë 46.4% (ALL97.8 mld ose US\$1,056.0 mln) ne 2009, dhe do pesoje rritje ne ALL211.8 mld ose US\$1,801.1 mln (40.4% e totalit), në 2019.

Ne Bote – Udhëtimet dhe Turizmi janë eksportuesit më të mëdhenj të vizitorëve duke injektuar valutë direct në ekonomi

Industria Shqiptare e Udhëtimeve dhe Turizmit – Nje veshtrim i shpejte ne shifra

Sipas Agjencisë Kombëtare të Turizmit shifrat për vizitorët e ardhur në Shqipëri gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 janë si më poshtë:




Figura 1. Numri I vizitoreve te ardhur ne Shqipëri gjate periudhes Janar – Qershor2009

Numri i turistëve që vijnë në Shqipëri rritet në mënyrë të konsiderueshme çdo vit. Ka patur gjithnjë një kërkesë gjithnjë e më të madhe të vizitorëve të huaj që dëshirojnë të vijnë në Shqipëri. Shifrat tregojnë që ka një rritje të besimit për Shqipërinë si destinacion turistik, gjë që provohet nga shifrat në rritje të flukseve turistike.

Në Qershor 2009 vendi ynë përjetoj një rritje prej 47.000 turistësh krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008. Nga një imazh negativ, sot Shqipëria ka shumë miq të cilët promovojnë vlerat unike natyrore, kulturore dhe historike të vendit. Revista se Balkan Traveler, dhe së shpejti National Geographic do të promovojnë nëpërmjet artikujve apo me aspekte filmike lloje të ndryshme të Turizmit në Shqipëri dhe rendisin Shqipërinë si një nga destinacionet më autentike në gjithë botën.




Figura 2. Vizitoret e ardhur ne Shqiperi sipas muajve (Janar – Qershor 2009)




Figura 3. Struktura e Vizitoreve te ardhur ne Shqiperi gjate periudhes Janar – Qershor 2009

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve aktualisht është e aftë të sigurojë një strukturë të saktë

të vizitorëve që vijnë në Shqipëri (sipas vetë deklarimit në kufi). Nga shifrat vërejmë që meqë vizitorët kanë ardhur më shumë gjatë muajve të verës janë vizitorët që vijnë për turizmin e diellit dhe ujit për shkak të verës së zgjatur në Shqipëri dhe plazheve të mrekullueshme. Deri tani nuk mund të themi që kemi zhvilluar një turizëm elitar por turizmi masiv është ende atraktiv për shumë segmente turistike.

Stabiliteti ekonomik dhe politik i vendit për momentin është jashtë cdo diskutimi. Zgjedhjet politike të vitit 2009 nuk patën asnjë lloj ndikimi negativ në numrin e turistëve që vijnë në Shqipëri.

Sipas Agjencisë Kombëtare të Turizmit gjatë periudhës Janar – Qershor 2009, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kishte një rritje prej 10 për qind në numrin e përgjithshëm të vizitorëve.

71 përqind e numrit të përgjithshëm kanë ardhur në Shqipëri nëpërmjet tokës, 19 përqind nëpërmjet ajrit dhe 10 përqind nga detet.

81 përqind e turistëve ka ardhur për pushime, 5 përqind për biznes, 3 përqind janë vizitorë ditorë ndersa 10 përqind janë për qëllime të tjera.

Numri më i madh i vizitorëve është nga Europa (92%), Amerika (5%), vizitorë nga Azia (2%) dhe nga vende të tjera vetëm 1%

Të ardhurat nga Turizmi janë:

Në 2007	1.002 milionë Euro
Ne 2008	1.170 milionë Euro
Tremujori i parë i 2009	212 milionë Euro

Turizmi i Kongreseve është rritur në gjysmën e parë të vitit 2009 duke arritur shifrën prej 26.261 persona.

Edhe turistët e biznesit po e vizitojnë destinacionet turistike të Shqipërisë gjatë pushimeve dhe fundjavave. Kjo të shtyn të mendosh që interesi i vizitorëve të huaj është duke u rritur në mënyrë të konsiderueshme. Gjithashtu po rritet në mënyrë të ndjeshme interesi i investitorëve për investime masive në turizëm .

Meqënëse turizmi po njih rritje në shumë zona të shqipërisë mendoj se Dibra paraqet një ofertë të pasur natyrore për zhvillimin e disa formave të turizmit duke iu shtuar paketave të ndryshme turistike. Kështu turizmi mund të ndihmojë në uljen e papunësisë dhe rritjen e të ardhurave për familjet dibrane. Industria turistike në Shqipëri aktualisht është fokusuar në zonat bregdetare ,por tendecat e reja turistike drejt turizmit rural,ekoturizmit,turizmit të aventurës dhe atij kulturor bëjnë të mundur përfshirjen e Dibrës në infrastrukturën turistike.

VLERESIMI I POTENCIALEVE TURISTIKE

DIBRA :POZITA GJEOGRAFIKE

Rrethi i Dibrës shtrihet në pjesën verilindore të Shqipërisë,në rajonin verilindor në të dyja anët e luginës së Drinit të Zi.Në lindje kufizohet me ish republikën Jugosllave të Maqedonisë, në veri me Kukësin, në veriperëndim me Mirditën, në jugperëndim me Bulqizën. Ka një sipërfaqe prej 1570km² midis gjatësisë gjeografike veriore 41° 53' 20" dhe gjerësisë gjeografike lindore 20° 34'50".

OFERTA GJEOGRAFIKE - TURISTIKE

Oferta gjeografiko-natyrore është një nga elementët e rëndësishëm të zhillimit turistik.Potenciali natyror i një zone të caktuar gjeografike përbën bazën e potencialit turistik primar pasi ai ka të bëjë me faktin si dhe në c'mënyrë mjedisi gjeografik natyror ndikon ne zhvillimin e turizmit në një hapësirë të caktuar gjeografike.Për të vlerësuar sa më mirë ofertën gjeografike të rrethit marrim në trajtim analizues të gjithë elementët natyrorë të tij.

NDËRTIMI GJEOLOGJIK

Studimi i ndërtimit gjeologjik pasqyrohet në pamjen e formave të jashtme të relievit duke i dhënë atij forma tërheqëse ose jo për syrin e turistit.Ndërtimi gjeologjik ndikon gjithashtu edhe në gjendjen e truallit icili do të përdoret për ndërtimin e objekteve të ndryshme të infrastrukturës turistike.

Rrethi i Dibrës ka një ndëtim të larmishëm gjeologjik.Vendin kryesor e zënë molasat e pliokuaternarit por gjejmë edhe rreshpet e paleozoit si dhe gëlqerorët e mesozoit që janë edhe formacoinet më të vjetra të vendit tonë.Shkëmbinjte efuzivë dhe flishet ndërtojnë skajin më jugor të vargut të korabit ku gjejmë edhe formacione karbonatike dhe ultrabazike. Ky ndërtim i shumëllojshëm gjeologjik ka mundësuar prezencën e pasurive të shumta nëntokësore dhe mbitokësore. Këto pasuri minerare metalore dhe jo metalore ku mund të përmendim kromin, gipset anhidrite, kuarcitet,gëlqerorët, mermeret mjaft cilësore por edhe minerale radioaktive si strociumi janë burime të rëndësishme ekonomike për rajonin.

RELIEVI

Format e relievit janë komponenti më i rëndësishëm i ofertës gjeografiko-turistike. Në përgjithësi turistët parapëlqejnë relievet me shumëllojshmëri formash në krahasim me ato monotone me pamje vetëm fushore apo malore.

Dibra është vend malor nga pikëpamja e relievit. Lartësia mbi nivelin e detit varion nga 600m deri në 2751m. Lartësia mesatare është 1118m.

Rajoni i Dibrës paraqet një shumëllojshmëri formash të relievit. Ndërtimi i shumëllojshëm litologjik ka ndikuar ndjeshëm në larminë dhe kompleksitetin e relievit të zonës e cila dallohet për një copëtim të dukshëm horizontal dhe vertikal. Në rajon takohen tipa të ndryshme të relievit si: strukturoro-eroziv, erozivodendues, karstik dhe akullnajor. Të gjitha këto tipa të relievit gërshetohen dhe ndërthuren me njëra -tjetrën duke krijuar kontraste të mëdha midis maleve të thepisura dhe luginave të thella e të ngushta duke krijuar kështu peizazhe natyrore shumë tërheqëse për syrin e turistit. Njësitë përbërëse të relievit të rajonit që me të vërtetë përbëjnë potenciale për zhvillimin formave të ndryshme të turizmit janë:

VARGU I KORABIT

Mali i Korabit përbën pjesën më të lartë të vargut me të njëjtin emër, duke qenë jo vetëm mali më i lartë i Shqipërisë (2751m), por edhe një nga më të lartët në Ballkan. Mali i Korabit shtrihet midis luginës së Përroit të Veleshicës dhe asaj të Përroit të Gramës. Mali të ofron një bukuri të rrallë. Ai mban mbi supë kreshta të përbëra nga guri gëlqeror dhe formacione gipsi të veshura me bimësi barishtore të kullotave alpine të llojeve të shumta. Burimet ujore, liqenet akullnajorë, pyjet halorë shfaqin një panoramë mahnitëse për vizitorët.

Kurrizi i Korabit ndahet në tre kreshta kryesore prej gropash kontakti, si ajo e Panairit, e Staneve të Preshit dhe e Bjeshkës së Shehut. Dy kreshtat e gropës së Panairit, ajo e Moravës (2716m) dhe ajo e Rosnikut (2567m), bashkohen tek maja e Korabit. Cirqet e shumta akullnajorë që skalitin këto kreshta dhe që formojnë cirqe komplekse, janë të ruajtura më mirë se kudo tjetër. Ato shtrihen në formë të shkallëzuar derisa përfundojnë në lugun akullnajor të Rrafshit të Korabit në veri dhe në gropën e Panairit në lindje. Kurse kreshta më e lartë Moravë -Korab, që ndan gropën e Panairit nga ajo e Staneve të Preshit, formon një rrëpirë 600-700m të lartë, që bie nga perëndimi mbi gropën e Staneve të Preshit.

GROPA E PANAIRIT

Njësi e madhe përbërëse e malit të Korabit me një peizazh të mrekullueshëm. Gropa e Panairit me formë vezake dhe fund të sheshtë të krijon idenë një stadiumi natyror në krye të të cilit rrjedh një burim me ujë shumë të ftohtë. Ajo varet mbi lugun akullnajor të Rrafshit të Korabit në veri me një prag mbi 200m të lartë.



RRAFSHI I KORABIT

Ky rrafsh nga vendasit njihet si Fusha e Korabit dhe historikisht ka shërbyer si urë lidhëse midis Kalasë së Dodës dhe Kosovës si dhe trevave shqiptare në Maqedoni. Kësaj fushe vendasit i kanë kushtuar plot këngë e legjenda. Rrafshi është pozicionuar në veri të malit në trajtën e një korite (govate) me gjatësi 3 km. Në të formohen disa pragje derisa zbret mbi fshatin Radomirë. Dëbora është një dukuri e përvitshme dhe me një kohëzgjatje pothuajse gjashtë mujore. Kjo dukuri dhe terreni i rrafshët e bëjnë rrafshin shumë të përshtatshëm për ndërtimin e pistave të skive apo aktiviteteve të tjera dimërore.

GROPA E STANEVE TE PRESHIT

Ndodhet në jugperëndim tëmalit të Korabit me formë të perzgjatur.Kjo gropë ka ka gjerësi më të madhe se ajo e Panairit.Në të formohen disa pragje deri në fshatin Radomirë.Në pragun më të poshtëm gjenden pesë liqene akullnajore që janë në tharje,por që akoma ruajnë vlera që shtohen këtij peizazhi.Më i madhi dhe më i bukuri ndër këto liqene është Liqeni i Zi.Liqeni ka një siperfaqe prej 0.8ha,me ujë të pastër dhe të ftohtë.

PORTAT E KORABIT

Kreshta tjetër e këtij mali është ajo e portave të Korabit,e cila ndahet nga vetë maja e korabitprej qafës me të njëjtin emër(2475 m lartësi).Kjo kreshtë, në të cilën lartësohen dy maja me lartësi mbi 2700m,ndan gropën e Staneve të Preshit në verilindje nga ajo e bjeshkës së Shehut në jugperëndim.Kjo e fundit, në ndryshim të gropave të lartpërmendura,është thelluar kaq shumë nga një degë e përroit të Veleshicës,saqë ka marrë më tepër tiparet e një lugine. Në shpatin lindor të kreshtës së Korabit takohen dhe mjaft forma të karstit nival,që përfaqësohen nga hinka,ulluqe dhe gropëza të ndryshme.Dukuritë e ngricave kanë cuar në formimin e rrjedhjeve të shumta gurore që zbresin nga këto kreshta drejt fundit të cirqeve duke idhënë peizazhit një pamje që të tërheq dhe të bën për vete.Në drejtim të malit të Gramës ky kurriz uletdhe bëhet gjithnjë e më i butë,sepse gëlqerorëti lënë vendin rreshpeve.Shpati perëndimor i këtij kurrizi bie mjaft pjerrët në shpatullën akullnajore të Bjeshkës së Zonjave duke formuar një prag litologjik.Ky prag i transformuar gjatë akullzimit ka afro 2 km gjatësi,gjerësi deri në 1 km dhe mbi të gjenden dy liqene akullnajore.Pjesa më mahnitëse në gjithë këtë peizazh është përroi i Lushit ,i njohur për pasurinë e madhe të biodiversitetit e vecanërisht të llojeve të rralla.



MALI I GRAMES

Në jug mali i Korabit vazhdon me malin e Gramës (2345m), që në jugperëndim arrin në formë të ngushtuar mbi qytetin e Peshkopisë. Në perëndim Grama ulet menjëherë mbi relievin e butë kodrinor të pellgut të Peshkopisë. Mbulesa bimore përfaqësohet gati tërësisht prej kullotave të pasura alpine që shfrytëzohen nga banorët vendas gjatë stinës së verës për kullotjen e bagëtive të imëta. Stanet e nritura prej tyre i shtojnë bukurinë këtij peizazhi duke u ofruar vizituesve të apasionuar pas jetës baritore ditë dhe netë me të vërtetë të paharrueshme.

LUGINA E DRINIT TË ZI

Kjo luginë shtrihet midis vargut malor të Korabit në lindje e vargmaleve të Lurës dhe malësive Martansh-Gollobordë në perëndim. Ajo rradhitet ndër luginat më të mëdha dhe më të rëndësishmetë vendit si nga tiparet fiziko-gjeografike, ashtu edhe vlerat ekonomike. Luginat fillonë skajin verior të liqenit të Ohrit dhe përfundon në pellgun e Kukësit ku bashkohet me luginën e Drinit të Bardhë. Luginat ka një gjatësi rreth 75

km.Lugina ndërtohet prej formacionesh të larmishme, ku vendin kryesor e zënë molasat pliokuaternare,gëlqerorët e mesozoit dhe pjesërisht rreshpet e paleozoit.Në përgjithësi lugina ka formë harkore me lugëzim nga lindja.Forma harkore e strukturave ka kushtëzuar jo vetëm një asimetri të theksuar midis shpateve të luginës,por edhe formën e lugët për shpatin e majtë dhe të djathtin.Kurse forma e shkallëzuar e shpateve të saj i detyrohet përbërjes së ndryshme litologjike dhe karakterit luspër të strukturave që e rrethojnë.Lugina gjatë gjithë gjatësisë së saj shpalos pamje tërheqëse në saj të ngushtimeve ,zgjerimeve dhe meandrimëve të shumta.

MASIVI MALOR KURORA E LURËS

Ky masiv paraqet një pamje mrekulëshme në të gjitha pikat e tij pasi akullzimi i kuaternarit ka llënë gjurmë të shumta, që perfaqësohen nga cirqe,vecanërisht në veri e veriperëndim të tij,shpatullinat dhe lugjet.Për shkak të lartësisë mbib 1500m dhe përbërjes magmatike ato janë të ruajtura mjaft mirë edhe sot.Cirqet zbresin në mënyrë të shkallëzuar deri në lartësinë 1700-1800m dhe humbasin gradualisht drejt jugut,paralelisht me uljen e lartësisë.Një pjesë e madhe e cirqeve janë kthyer në liqene.Në shpatin lindor të kurorës së Lurës ndodhet parku kombëtar i lurës,i konsideruar si një nga perlat e natyrës shqiptare.Parku ndodhet rreth 55 km larg nga qyteti i peshkopisë.Eshtë pjesa me florën dhe faunën më të vecantë në rajonin e Dibrës.Parku shtrihet në lartësinë 1375-1919m mbi nivelin e detit.Parku ka një sipërfaqe prej 1280ha nga të cilat 1100ha janë pyje,50ha janë livadhe dhe 30ha janë sipërfaqe liqenore.I gjithë parku është një kompleks me bukuri të madhe, por disa njësi të vecanta të tij të krijojnë kënaqësi që me pamjen e parë:

FUSHA E PELAVE

Shtrihet në lartësinë mbi detare 1580m dhe ndodhet në pjesën jugore të parkut.Eshtë një livadh alpin me një sipërfaqe prej 18ha me bukuri të vecantë,që i ka zënë vendin një liqeni akullnajor tashmë të tharë.Livadhi ka një florë të larmishme barishtore rrethuar nga drurë halorë shekullorë .Në zhvillimin e kësaj mbulese bimore të pasur e të shumëllojshme rol të madh luan ekspozicioni i shpatit.Fusha me shtrirjen e saj të madhe hapësinore krijon kushte mjaft të përshtatshme dhe të favorshme për ngritjen e kampingjeve dhe ndërtimin e pistave të skive.

LIQENET E LURËS

Liqenet e Lurës janë të njohura në të gjithë shqipërinë për bukurinë mahnitëse të tyre.Liqenet shtrihen tërësisht në shpatin lindor të parkut, në pragun e Nezhdës së Lures dhe lidhen me relievin e butë të këtij pragu, i transformuar në një shpatullinë akullnajore. Në ruajtjen e këtyre liqeneve deri në ditët e sotme ka luajtur rol të madh pikërisht ekspozimi në shpatin lindor.Liqenet janë dymbëdhjetë gjithsej,por vetëm shtatë prej tyre kanë ujë gjatë gjithë vitit.Liqenet formojnë një ekosistem të pasur në bimësi hidrophile dhe faunë ujore të pasur.



Liqenet kryesore të parkut janë:

Liqeni i luleve:ka sipërfaqe 1.44ha,thellës i 0.8m dhe lartësi ndga niveli i detit1585m me sipërfaqe ujore të mbuluar nga lulet e zambakut të ujit.

Liqeni i Zi:ka sipërfaqe 2.5 ha,thellësi 10m dhe lartësi nga niveli i detit1620m.

Liqeni i Madh: ka sipërfaqe 11.8 ha,gjatësi 423m,gjerësi 300m,thellësi 20m dhe lartësi nga niveli i detit 1722m.

Liqeni i Kallabës: ka sipërfaqe 3.6 ha,thellësi 12m dhe lartësi nga niveli i detit 1575m.

Liqeni i Rasave: ka sipërfaqe 0.4 ha,thellësi 2.5m dhe lartësi mbi nivelin e detit 1600m.

Liqeni i Hotit: ka sipërfaqe 1.84 ha,thellësi 3m dhe lartësi mbi nivelin e detit 1500m.

Liqeni i Kalatës:ka sipërfaqe 3.6 ha,thellësi 12m dhe lartësi mbi nivelin e detit 1500m.

Hapësira rreth liqeneve ,pavarësisht dëmtimit të madh që ka pësuar në këto vitet e fundit,ofron kushte të përshtatshme për ngritjen e kampingjeve,zhvillimin e turizmit liqenor, peshkimit ,shëtitjeve në natyrë etj.

LUGINA E SETËS

Përbën një nësi interesante e relievit të zonës.E pozicionuar mes Runjës së Peshkopisë dhe Runjës së lurës shpalos para syve të vizitorit një pamje të mrekullueshme pothuajse të paprekur nga dora e njeriut.Tipari dallues i kësaj lugine është se pjesa e sipërme e saj përbën një luginë tipike kontakti në formë "V"-je,duke u zgjatur paralel me kreshtat rrethuese.Kjo luginë vjen e zgjerohet gradualisht derisa përfundon në pellgun e

Setës para se të kthehet menjëherë nga lindja. Ky pellg gati në formë të rrumbullakët, ka një diametër afro 3km. Në dalje të këtij pellgu lugina formon grykë në ngjyrtë e mjaft të thellë (300-400m) të Setës. Këtu përfundon edhe gryka e Përroit të Thatë, e cila i jep Grykës së Setës një pamje madhështore, për shkak të humnerave gëlqerore shumë të thella dhe kanioneve. Përroi i Setës përfundon në luginën e Drinit të Zi me një grykëderdhje mjaft të gjerë.

MALI I BALGJAJT

Strihet në perëndim të Vargjeve të Lurës. Përbërja e tij tërësisht prej shkëmbinjve ultra bazikë ka kushtëzuar copëtimin e madh vertikal dhe horizontal të tij duke i dhënë një larmi formash peizazhit të tij. Mali i Balgjajt dallohet për numrin më të madh të cirqeve e të liqeneve akullnajore në vendin tonë. Këtu numërohen pesë cirqe shumë të mëdha, me diametër 2-2.5km, në të cilat shtrihen edhe 18 liqene akullnajore. Nga cirqet dhe liqenet dalin përrenj të shumtë që përshkojnë shpatin verior dhe perëndimor të Balgjajt, sepse ushqehen rregullisht nga ujërat e liqeneve. Natyra e qetë, peizazhi i mrekullueshëm, ujërat e pastër të liqeneve, ajri i freskët i malit e bëjnë një vend mëse të përshtatshëm për lodhje dhe rekreacion gjatë stinës së verës. Dëbora është një dukuri e përvitshme dhe me një shtresë relativisht të trashë dhe të qëndrueshme nga muaji nëntor deri në muajin maj, duke krijuar kështu kushte të përshtatshme për zhvillimin e sporteve dimërore.

BURIMET E BELLOVËS

Janë burime termominerale në shpatin lindor të malit të Deshatit. Ato njihen për vlerat e larta të ujërave të tyre si dhe përmbajtjen e lartë të squfurit. Kjo i bën të përdorshme këto ujra në kurimin e shumë sëmundjeve. Ndrthurja e bimësisë dhe firmave të larmishme të krijuara në shpatin e malit si dhe relievi interesant i Përroit të Banjave e bëjnë burimin një vend me interes për tu vizituar. Pranë burimeve është ngritur edhe një qendër balneare.

MONUMENTET E NATYRËS


Në rrethin e Dibrës gjenden një numër i madh i monumenteve të natyrës që ia shtojnë edhe më tepër vlerat mjedisit natyror të rajonit, por me karakteristikat e tyre mjaft të spikatura përbëjnë një pasuri kombëtare. Përveç vlerave shkencore dhe ekonomike këto monumente paraqesin edhe vlera të mëdha estetike duke ofruar potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit. Ky zhvillim mund të shndërrohet në burim gjenerues të ardhurash për banorët vendas. Në rajon janë identifikuar 22 objekte, 12 prej të cilave janë monumente të rëndësishme kombëtare. Disa prej tyre po i analizojmë më poshtë:

BOROVIKU I BEGJUNECIT

Ndodhet në afërsi të fshatit Rabdishtë në lartësinë nga 758m në 1350m mbi nivelin e detit. Ky masiv pyjor ka një botë bimore shumë të pasur e cila varion nga ajo barishtore deri tek pemët e larta shumëvjecare. Pisha, ahu, lajthitë, panja, frashëri dhe dushku krijojnë një koktejl natyror që ia shtojnë masivitetin vlerat ekologjike, shkencore dhe sigurisht edhe turistike. Vlerat e këtij masivi shtohen edhe më tepër me faunën e pasur që gëlon në të. Përveç llojeve të ndryshme të insekteve, amfibëve, zvarranikëve dhe shpendëve në masivin pyjor të Borovikut jetojnë edhe lloje të shumta gjitarësh ku nuk mund të lë pa përmendur një ndër kafshët e rralla të zonës, kaprollin. Boroviku i Begjunecit ofron mundësi për zhvillimin e sportit të gjuetisë, ngritjen e kampingjeve etj.

UJË VARA E POCESTËS

Ndodhet në shpatin lindor të malit të Deshatit, në afërsi të fshatit Maqellarë, në lartësinë 1500m. Uji del nga një e carë e madhe në shkëmbin gëlqeror. Terreni flishor dhe gëlqeror mundëson krijimin e një bërime të madh karstik i cili vijon më tej në trajtën e një ujëvare. Ujëvara bie nga një lartësi prej 13m dhe gumëzhimi iujit që bie dëgjohet nga larg. Peizazhin malor ku ujëvara është e pozicionuar i jep asaj një pamje magjepsëse.



SHPELLAT

Janë një tjetër element i ofertës gjeografiko-natyrore të zonës. Përbërja litologjike shumëllojshme si dhe fazat e ndryshme gjeologjike gjatë së cilave u formësua relievi i rajonit të Dibrës kombinuar me faktorët e jashtëm klimatik kanë mundësuar prezencën e një numri të shumtë shpellash në rajon. Shumica prej tyre të paeksploruara deri më tani, ofrojnë një mundësi të mirë për tërheqjen e asaj pjese të lëvizjes turistike të apasionuar pas speleologjisë. Shumë prej shpellave janë të veshura me petkun e magjisë nga legjendat dhe gojëdhënat e shumta që popullsia vendase ka thurur për to. Ndër më të njohurat dhe më të mëdhatë mund të përmendim:

SHPELLA E BELLOVËS

Është një shpellë karstike e formuar në gipset e permianit të sipërm. Ajo ndodhet në lindje të qytetit të Peshkopisë, në sektorin sipërm të luginës së Përroit të Banjave, që ka tiparet e një pellgu të madh në formë freskoreje dhe perbën edhe kufirin natyror midis malit të Gramës dhe atij të Deshatit. Shpella e

pozicionuar në afërsi të fshatit Bellovë, nga i cili ka marrë edhe emrin, gjendet në lartësinë 1400m mbi nivelin e detit. Përveç vlerave natyrore shpella e Bellovës paraqet edhe vlera historiko-arkeo-logjike pasi në brendësi të saj janë gjetur gjurmë të veprimtarisë së njeriut të lashtë.

SHPELLA E AKULLIT BULAC

Është gjithashtu një shpellë e ndërtuar tërësisht nga gëlqerorë të triasit me një strukturë të qartë luspure. Shpella ndodhet në afërsi të fshatit Bulac, të komunës Muhurr, në shpatin verior të Runjes së Peshkopisë. Shpella ndodhet në lartësinë rreth 1800m mbi nivelin e detit. Shpella e bulacit ka një fizionomi të ndryshme me të shpellave të tjera të rajonit. Ajo ka formën e një pusi me thellësi prej 50metrash. E vetmja mënyrë për të eksploruar tabanin e saj të mbuluar nga një shtresë akulli të trashë është zbritja me litar. Hyrja e ngushtë të jep mundësinë të shijosh hap pas hapi bukuritë e saj. Brenda në shpellë temperaturat janë nën zero gradë duke mundësuar kështu prezencën e akullit gjatë gjithë vitit. Vendasit e kanë përdorur shpellën si një ftohës natyror gjatë stinës së verës dhe si burim kubesh akulli .

SHPELLA DHE BURIMI I SOPANIKËS

Gëlqerorët janë formacionet kryesore të përbërjes gjeologjike të shpellës. Ajo është e pozicionuar në shpatin perëndimor të malit të Runjes së Peshkopisë, që bie si thikë në Grykën e Setës. Në brendësi të shpellës burojnë sasi të konsiderueshme uji ,një pjesë e të cilit del nga gryka e shpellës në trajtën e një përroi të nëndheshëm. një pjesë tjetër uji humbet në brendësi të shpellës në rrjedhje nëntokësore. Një sasi e madhe uji mblidhet në një rezervuar të ndërtuar së fundmi nga njësitë vendore për përdorim bujqësor dhe ujë të pijshëm. Karakteristikë për shpellën është fakti se uji buron nga tavani i shpellës dhe jo nga tabani i

saj. Përbërja gëlqerore dhe prania e ujrave nëntokësore kanë mundësuar zhvillimin e procesit të karstit, të shprehur në prezencën e stalaktiteve dhe stalagmiteve. Shpella ndodhet në lartësinë 800m mbi nivelin e detit. Shpella ka përmasa të konsiderueshme. Në hyrje të saj ajo ka një gjerësi prej 10-11metrash që vjen duke u ngushtuar drejt fundit. Ajo ka një gjatësi prej 70-80 metrash dhe lartësi prej 12metrash. Vetë pozicioni i saj në shpatin që bie thikë mbi Setë i jep një pamje unike.

SHPELLA E BOROVIËS:

Është e paeksploruar. Në brendësi të saj ka prani të madhe të dioksidit të karbonit. Mbase ky është fakti i qarkullimit të gojëdhënave rreth saj. Sipas gojëdhënës pak metra pasi futesh në shpellë ndeshesh me një liqen. Thuhet se mes për mes tij është ndërtuar një mur i fshehur brenda në ujë. Duke ecur mbi këtë mur gjendesh përpara dy gurëve të mëdhenj të cilët nëse i lëviz me anë të një leve shfaqet një derë mbi të cilën është gdhendur një gjarpër. Pasi të hapësh derën e gurtë hyn në dhomën e thesarit.

Në rajon ndodhen dhe një sërë shpeshash të tjera si:

Shpella e Ostrenit të Madh

Shpella e Kamës së Atit

Shpella e Gjurasit

Shpella e Shorokanit:

Shpella e Pëllumbit;

Shpella e Kllogjerit



KLIMA

Eshtë një komponent shumë i rëndësishëm në ofertën gjeografiko-natyrore dhe përbën një nga kushtet natyrore vendimtare në zhvillimin turistik të hapësirave të caktuara gjeografike. Me motin dhe klimën lidhen jovetëm efektet rekreative dhe shëndetësore, por edhe kohëzgjatja e sezoneve turistike. Klima përbëhet nga shumë elementë si: temperatura e ajrit, reshjet, sasia e ditëve me diell apo me shtresë dëbore, drejtimi i erës etj., janë përcaktues të ecurisë së turizmit të një rajoni gjeografik. Rrethi i Dibrës karakterizohet nga një klimë mesdhetare malore me praninë edhe të mikroklimave që formohen në njësi të ndryshme të rajonit të cilat shoqërohen me ndryshime përkatëse në mbulesën bimore, shumëllojshmërinë e tokave dhe të botës shtazore. Rajoni dallohet për numrin e madh të ditëve me diell gjithashtu edhe për trashësinë dhe numrin e madh të ditëve me shtresë bore (117 ditë në Fushë Lurë). Mesatarja vjetore e temperaturës është 11.3°C. Mesatarja e muajve të ftohtë është -0.1°C dhe atyre më të ngrohtë 21°C. Sasia vjetore e reshjeve shkon në 719-751mm, ku sasinë më të madhe e zënë rreshjet e borës. Në luginën e Drinit të Zi sasia mesatare e rreshjeve varion nga 800-1200mm në vit të përqëndruar kryesisht në stinën e dimrit. Bora e përvitshme me shtresë të qëndrueshme si dhe disa pjesë të relievit të sipërpërmendura janë mëse të favorshme për ndërtimin e resorteve turistike dimërore dhe pista skish. Ditët me diell, temperaturat e larta dhe sasia e vogël e rreshjeve e bëjnë stinën e verës po aq tërheqëse sa dhe dimri në shumëllojshmërinë e aktiviteteve që mund të zhvillohen.

FLORA&FAUNA

Prezenca e pyjeve dhe sipërfaqeve të gjelbërta pasurojnë më tepër ofertën natyrore turistike të zonave të ndryshme turistike. Kur prania e gjelbërimit kombinohet me prezencën e sipërfaqes ujore dhe elementët klimatikë të përshtatshëm, krijohen kushte ideale natyrore për zhvillimin e formave të ndryshme turistike. Pa ofruar poenciale të tyre të vecanta bimore çdo ofertë gjeografiko-natyrore në fushën e turizmit nuk mund të kuptohet e plotë. Rëndësia turistike e botës bimore rritet akoma më tepër kur ajo shoqërohet edhe nga një

botë shtazore e pasur me kafshë e shpendë të ndryshëm. Jeta e kafshëve dhe shpendëve si në gjendjen e tyre të lirë mes pyjeve të dendur, ashtu edhe në kopshte e parqe zoologjike, është një motiv i lëvizjes turistike.

Rrethi i Dibrës dallohet si një nga rrethet me florë dhe faunë të pasur si në lloje dhe në shtrirje. Në vargmalin e Korabit mbizotëron bimësia barishtore por gjenden edhe formacione pyjore që përfaqësohet me katin e dushkut (nga 400-1100m) dhe përbëhet nga qarri e bunga. Kati i ahut i përqëndruar në disa sektorë të këtij vargu ka shpërndarje mjaft të crregullt. Shtrirjen më të gjerë, ku formon dhe pyje të dendura, ky brez e ka në malin e Deshatit, ndërsa në malin e Gramës ahut formon areale mjaft të ngushta ose zëvendësohet nga pyjet me pishë të zezë. Lugina e Drinit të Zi në pjesën më të madhe mbulohet nga brezi i dushkut dhe shkurreve. Një pjesë e brezit bimor të luginës zihet nga blloqet e pemëve frutore të ringritura pas dëmtimit që iu bë atyre pas rënies së rregjimit të komunist. Vargu malor i Lurës dallohet për një mbulesë të pasur bimore që i përket tërësisht brezit të ahut, rrobullit, pishës së zezë dhe të bardhë si dhe arnit. Kullotat alpine janë të përhapura gjerësisht në lartësinë 1800-2000m mbi nivelin e detit në të gjitha njësitë malore të rajonit. Ato janë mjaft të pasura dhe formojnë një rezervë të madhe kullotash verore, të shfytëzuara gjerësisht nga vendasit. Bota bimore e pasur në lloje dhe shtrirje shoqërohet me një faunë të pasur. Kafshët e egra grabitqare përfaqësohen nga ujku (*canis lupus*), dhelpra (*canis vulpes*), ariu i murmë (*ursus aretos*), rrëqebulli (*felix lumxe*), macja e egër (*felix silvestris*), kunadhia (*martes martes L*) dhe vjedulla (*males faxus badd*). Kafshët e egra jo grabitqare përfaqësohen nga ketri (*Sciurus vulgaris L*), dhia e egër (*Rupicarpa rupicarpa L*), derri i egër (*Sus scofa*) dhe lepuri (*Lepurus europens*). Takohen një numër i konsiderueshëm zvarranikësh dhe amfibësh si nepërka, bolla, lloje të ndryshme hardhucash, bretkosash etj. Fauna ujore është gjithashtu e pasur. Trofta është banore e ujërave të lumenjve dhe liqeneve të zonës, duke i bërë këta të fundit të përshtatshëm për peshkim.

HIDROGRAFIA

Pasuria ujore përbën një tjetër element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm për zhvillimin e zonave turistike. Detet, lumenjtë, liqenet dhe burimet ujore kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në potencialin turistik të zonave të ndryshme gjeografike. Prania e ujërave krijon rrethana për zhvillimin e sporteve të ndryshme ujore të pëlqyera nganjë numër i madh njerëzish kudo në botë. Liqenet dhe lumenjtë po tërheqin gjithmonë e më tepër një numër të konsiderueshëm turistësh. Joshja e tyre qëndron si në mundësinë e banjave diellore, ashtu edhe në sportet e ndryshme ujore apo bukuritë që paraqet kaskada që ato formojnë. Motive të rëndësishme të lëvizjes turistike përbëjnë edhe burimet natyrore ujore, sidomos ato termominerare. Përvec bukurisë natyrore që kjojnë këto burime, ato shërbejnë edhe si qendra kurative dhe fizioterapike për shumë pushues. Uji përbën gjithashtu një faktor kyç edhe në ndërtimin e infrastrukturës turistike, pasi lidhet me nevojat për furnizim me ujë të objekteve turistike në përputhje me kërkesat e klientelës turistike. Rrethi i Dibrës karakterizohet nga një rrjet i pasur hidrografik. Ky rrjet përfaqësohet nga një numër i madh liqenesh akullnajorë, burimesh nëntokësore si dhe përrenjsh malorë të cilët përbëjnë pellgun ujëmbledhës të Drinit të Zi. Lumenjtë kryesorë janë: Drini i Zi, Seta, Murra dhe Zalli i Bulqizës. Liqenet akullnajore të Lurës, të

Kacnisë, të vargut të Korabit janë pjesë e pasurisë ujore të rajonit. Përrenjtë janë të shumtë në rajon dhe në përgjithësi kanë prurje të vazhdueshme gjatë gjithë vitit. Rregjimi i rrjedhjes së këtyre përrenjve është në varësi të rreshjeve të borës dhe të shiut. Prurjen më të madhe e kanë gjatë muajve maj- qershor dhe në nëntor. Ndër përrenjtë kryesorë të rajonit mund të përmendim: Përroi i Gramës, përroi i Veleshicës, Përroi i Thatë, Përroi i Urakës, Përroi i Banjave si dhe një numër i konsiderueshëm përrenjsh të tjerë më të vegjël. Ky rrjet i dendur përrenjsh dhe lumenjsh mundësojnë zhvillimin e një sërë sportesh ujore si peshkimi, rafting, banjat e diellit etj.

Të gjithë komponentët natyrorë të sipërpërmendura janë të domosdoshëm për t'u trajtuar dhe vlerësuar nga pikëpamja gjeografike në mënyrë që:

- të zhvillohet turizmi në përshtatje me gjendjen aktuale të mjedisit natyror.

- të hartohen strategji dhe politika që të mund të pretendohet për një turizëm të qëndrueshëm, afatgjatë dhe që respekton këto elemente të natyrës.

OFERTA GJEOGRAFIKO-KULTURORE

Në potencialin turistik primar të një vendi krahas ofertës gjeografike natyrore zë vend të pazëvendësueshëm edhe oferta gjeografiko-kulturore. Në këtë ofertë përfshihet e gjithë trashëgimia materiale, e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe ajo shpirtërore e një populli ose vendi, e cila vihet në shërbim të zhvillimit turistik. Çdo objekt historik dhe kulturor, tradita artizanale, arti i të gatuarit, folklori, veshjet apo mënyra e jetesës janë pjesë të pasurisë kulturore dhe historike. E gjithë kjo pasuri paraqet motive tepër të rëndësishme për zgjerimin e ofertës turistike. Ky zgjerim sjell efekte pozitive në aspektin ekonomik, por edhe në ngritjen e imazhit turistik të rajoneve. Motivet kulturore u japin qarkullimeve turistike fizionomi më komplekse dhe krijojnë kushte për qëndrim më të gjatë në një vend. Përmes formave të turizmit kulturor është bërë e mundur që të zbulohen dhe të vlerësohet ndërkombëtarisht në të gjitha kohërat diversiteti dhe pasuria kulturore e mbarë njerëzimit. Turizmi kulturor është një mjet për komunikimin ndërkulturor dhe mirëkuptimin ndërkombëtar; ndërkohësisht i dialogut mes qytetërimeve, një mjet i aftë të ndërtojë paqen në mendjen e njerëzve.

Treva e Dibrës dhe trashëgimia e saj kulturore.

Populli shqiptar ka kaluar nëpër një histori të vështirë me shumë ngjarje heroike dhe tragjike. Nuk ka ndoshta vend tjetër në Europë që të ketë provuar në historinë e tij kaq shumë kthesa e drama sa populli shqiptar. Këto kushte historike dhe shumë faktorë të tjerë kanë si rezultat faktin që historia dhe kultura shqiptare kanë shumë për të treguar. Edhe treva e Dibrës me trashëgiminë materiale dhe shpirtërore të saj plotëson më së miri mozaikun historik dhe kulturor të popullit tonë.

KALAJA E GRAZHDANIT

Është shpallur monument kulture në vitin 1963 me vendim të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës, nr.6, dt 15.01.1963 "Mbi shpalljen e monumenteve të kulturës". Thuajse larg syve të vizitorëve, në heshtje të plotë kalaja madhështore e Grazhdanit në afërsi të Maqëllarës në Dibër, fsheh qindra surpriza nga bota antike. Është kalaja më e madhe në Shqipëri, e mbase edhe në Ballkan. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 34 hektarësh, me një mur rrethues prej 3.5 kilometrash të gjatë duke e bërë lehtësisht të krahasueshme me Butrintin, Bylisin apo qendra të tjera antike. Kjo kala ka rëndësi sepse mendohet që ishte pikërisht ajo që në antikitet i dha emrin krahinës së Dibrës. Ky monument është njohur në literaturë nga udhëtimi që bëri Johan George Von Han, i cili shkroi për Grazhdanin në librin e tij "Udhëtimi nga Danubi në Drin."

Në kala janë ndërmarë disa ekspedita arkeologjike me qëllim nxjerrjen në dritë të gjithë historisë së zhvillimit antik të kësaj qendre.

Së fundmi është zbuluar ekzistenca e një porte madhështore të kalase me një sipërfaqe prej 1 mijë metra katrorësh e cila përbëhet nga dy kulla në formën e gërmës U, të dyja të gjata nga 24 metra dhe mes tyre hyrja me një gjerësi 9.2 metrash.

Nga përmasat dhe ndërtimi arkitektonik kjo është një kullë e shekullit të katërt e ndërtuar në kohën e perandorit Kostandini i Madh, mjaft e rrallë në Shqipëri, pasi këto janë porta me hyrje monumentale me hark triumfi. Një e tillë ka qënë në fillim të rrugës Egnatia në Durrës dhe një tjetër në Via Apia në Romë.

KALAJA E SKËNDERBEUT

Është një tjetër kala që rrit vlerat kulturore dhe historike të rajonit. E ndërtuar gjatë periudhës së ndritur të Skënderbeut ajo është një pjesë e ofertës kulturore që nuk duhet humbur. Kalaja është pozicionuar në një reliev të ashpër dhe mund të arrihet nëpërmjet një rruge të ngushtë dhe të vështirë. Vetëm të apasionuarit pas turizmit aventuresk do ta gjejnë kënaqësinë duke u përpjekur të vizitojnë kështjellën. Rruga drejt saj është një nga pjesët më mbreslënëse të luginës së Setës.

KULLAT

Janë banesa tipologjike të trevës së Dibrës. Kulla është e pasur me elemente dekorative si arkitrarë prej guri të gdhendur në formë harku në derën e jashtme e dritare dhe tavan dekorativ prej dërrase në dhomën e miqve. Kulla është e ndërtuar me tre ose katër kate. Në çdo kat ndodhet nga një ambient banimi. Për tu ngjitur nga njëri kat në tjetrin shërbejnë shkallët prej druri të cilat janë të pozicionuara në ambjentin e brendshëm të kullës. Shashanet janë një tjetër ambjent i kullës. Ato ndërtoheshin me dritare dhe frëngji nga mund të sodisësh dhe vrojtosh ambjentin rreth e rrotull kullës. Dritaret e kullës janë të vogla dhe nga brenda gjatë natës mbyllen me kapak të rëndë prej druri. Frëngjitë janë një tjetër element interesant i kullës. Ato shërbejnë si element luftimi. Në përgjithësi muret e kullës janë të bëra me gurë dhe llac gëlqereje. Ka dhe

kulla,muret e të cilave janë të ndërtuara me cerpic të lidhura me brez druri.Kati i parë i kullës ka shërbyer si ahuri i bagëtime,i dyti si dhoma e zjarrit ku bënte jetën familja dhe i treti si dhoma e miqve.Kullat e Dibrës kanë shërbyer edhe si objekte fortifikuese luftimi.Nder kullat më të njohura dhe aktualisht në gjendje të mirë për pritjen e vizitorëve përmendim:

KULLA E RESHIT ZUNËS

Është shpallur Monument Kulture në vitin 1977 me shkresën e Ministrië së Arsimit dhe Kulturës,dt.08.01.1977.Kulla është e ndërtuar në fshatin Sohodoll,në lagjen Miravec,ku banon fisi Zunajve.Ajo është një ndërtesë katerkatëshe me nga një mjedis per secilin kat.Kati përdhes përdorej nga shërbëtorët.Tre katet e tjera kanë shërbyer për përdorim familjar dhe pritjen e miqve.Mjediset e kullës ndricohen nga dritaret të cilat janë të mëdha,element ky që e dallon nga të tjerat.Murret e saj janë një tjetër element dallues pasi janë të ndërtuara me gur poroz(shtufi).Qoshet e ndërtesës janë të ndërtuara me gurë më të mëdhenj dhe të gdhendur me kujdes.Objekti është i rrethuar me avlli*.Avllia është gjithashtu e ndërtuar me gurë të lidhur me strukturë druri.Ne dy anët e portës kryesore,nga e cila hyn në oborrin e kullës,ndodhen sofrat*.

KULLA E SALI MARKËS

Është shpallur monument kulture në të njëjtën periudhë me kullën e zuës.Ajo ndodhet në fshatin Zogje, në komunën e Shupenzës.Eshtë lehtësisht e dallueshme pasi është ndërtuar në një terren dominues me pamje të mëirë të të gjithë fshatit.Kulla është një ndërtesë katërkatëshe .Ajo ka qënë e lidhur me ndërtesa më të vogla duke krijuar kështu imazhin e në minikalaje.Ndërtesa ka disa karakteristika të vecanta që e bëjnë lehtësisht të dallueshme nga të tjerat. shkallët janë tipari i parë dallues ,pasi ato janë të ndërtuara nga jashtë.Hajati prej druri në formë katrore brenda ndërtesës,catia me rrasa guri,muret e ndërtuara me gurë të latuar dhe gëlqere dhe breza druri të padukshëm janë të jerë elementë dallues të saj.

-Kulla e Tollës:

-Kulla e Dine Hoxhës:

-KULLA E MURRËS

Është ndërtuar në fshatin Hoteshe,të komunës Luzni,në mesin e shekullit të XIX.Ajo është e pozicionuar në majë të një kodre njëra faqe e së cilës bie pingul mbi ujrat Drinit të Zi.Në këtë mënyrë ajo kishte në kontroll të plotë lëvizjet në luginë,duke luajtur një rol të mirëfilltë të kullës së vrojtimit.

Avllia -> mur rrethues i oborrit të një shtëpie apo kulle

Sofra -> stol prej guri i vendosur në të dy anët e portës së avllisë


KULLA E PËRLEKËS:

Tjetër banesë karakteristike në rajon është banesa me "qoshe". Ky tip është i realizuar me dy-tri kate dhe takohet së tepërmi në krainën e Zerqanit dhe të Bulqizës. Në zonat më fushore hasen banesa me hajat ose cardak, të cilat shërbejnë si mjedise clodhëse, por edhe ku përpunohen e thahen produktet bujqësore si misri, gruri, bunguri, kunguj etj. Shëmë interesante në banesën karakteristike janë gdhendjet artistike në qoshet e shtëpive, gdhendjet mjeshtërore të tavaneve prej druri si dhe oxhaqet e zbukuruara kryesisht me motivin e shqiponjës.

Objektet e kultit

Dibra ashtu si të gjitha trevat e tjera shqiptare e ka të zhilluar tolerancën fetare ndër shekuj. Besimet fetare në rajon kanë bashkëjetuar në paqe dhe harmoni me njëri-tjetrin duke pasuruar kështu traditat kulturore dhe fetare të zonës. Kjo harmoni shprehet qartazi edhe në vendet e adhurimit në zonë. Shumë nga objektet e kultit datojnë që nga periudha bizantine apo fillimet e pushtimit osman në Shqipëri. Ndër to mund të përmendim:

- Xhamia e Allajbegisë
- Kisha e Shpërfytyrimit
- Kisha e Cveti Spas
- Kisha e Shën Mitrit
- Xhamia e Peshkopisë
- Teqeja e Shorokanit



XHAMIA E ALLAJBEGISË

Është ndërtuar në vitin 1585 në lindje të fshatit Burim (Allajbegi). Ajo ka formë kubike me kupolë. Minarja e saj ka bazament shumë faqesh. Salla e lutjeve ka këto përmasa: gjatësi 6.4m dhe gjerësi 6.27m. Brenda në xhami janë të ndërtuara salla studimi. Xhamia ka 10 dritare të ndërtuara me korniza guri. Kjo xhami është ndërtuar me një teknikë artizanale nga mjeshtër vendas të bazuar në kulturën shqiptare të ndërtimit. Në vitin 1970 zuri vënd në listën e monumenteve kulturore kombëtare.

KISHA E SHPËRFYTYRIMIT

Është një objekt i vjetër kulturi me prezencë të cilit dëshmon për besimin fetar në periudhën bizantine. Kisha ndodhet në fshatin Herbel. Është ndërtuar me një teknikë të thjeshtë, Pranus-Nauso-Absieda tre faqësh. Pavarësisht se paraqet fragmente të kulturës bizantine të periudhës së hershme mesjetare, teknika e ndërtimit është tërësisht artizanale. Kisha e Shpërfytyrimit u bë pjesë e listës së monumenteve të kulturës në vitin 1970 për shkak të vlerave historike dhe kulturore që ajo ruan.

KISHA E CVETI SPAS(SHËN SOFIA)

Është ndërtuar në vitin 1270.Ajo ndodhet në fshatin Kërcisht,të komunës Maqëllarë.Cveti Spas ka një teknikë të thjeshtë ndërtimi Prononus-Nanus-Abside.Muret e saj janë ndërtuar me gurë të lidhur me llac gëlqereje,ndërsa catinë e ka të mbuluar me rrasa guri.Në muret e brendshme të saj ruhen afreske,të cilat për fat të keq janë në gjendje jo të mirë.Në vitin2007 kisha është shpallur monument kulture.

MUZEU I PESHKOPISE

Për ato vizitorë të cilët janë të interesuar të njohin më mirë historinë e Dibrës muzeu i peshkopisë është një mundësi e mirë.Ai është i pozicionuar në qendër të qytetit.Përbëhet nga tre pavione:

Pavioni i arkeologjisë, i cili është mjaft i pasur dhe dëshmon për një banim shumë të hershëm të rajonit që nga periudha paleolitike.

Pavioni i historisë, në të cilin janë ekspozuar veprimtaria e atdhetarëve dibrane për mbrojtjen e interesave kombëtare dhe krahinore në periudha të ndryshme të historisë së trazuar të popullit tonë.

Pavioni i etnografisë:pasqyron një pjesë të kulturës materiale të luajtshme të Dibrës e cila është mjaft e larmishme.

ETNOGRAFIA

Është pjesë e pandarë e trashëgimisë kulturore.Ajo përfshin gjithë pasurinë materiale dhe shpirtërore që ofron popullsia e një vendi në fushën e turizmit.Pasuri etnografike të tilla si:veshjet kombëtare,prodhimet artizanale,folklori,instrumentet muzikore,ritet e ndryshme fetare dhe jofetare etj. përbëjnë motive të rëndësishme kulturore të cilat zgjerojnë ofertën turistike të një vendi.Kostumet popullore të trevës së dibrës janë një pjesë tërheqëse e trashëgimisë kulturore dibrane.Numërohen tetë prej tyre,një i burrave dhe shtatë të grave.Secili prej këtyre tipeve shfaq një larmi ngjyrash dhe punimesh të gërshetuara hijshëm me njëra-tjetrën.Sipas karakteristikave që ato paraqesin kostumet popullore të grave grupohen:

- Kostume popullore të krahinës së Zerqanit dhe Bulqizës
- Kostume popullore të Gollobordës
- Kostume popullore të Ujë më Ujës*
- Kostume popullore të fshatrave në perëndim të Drinit të Zi
- Kostume popullore të zonës së Shupenzes
- Veshje të Fushës së Shehrit

Ujë më Ujës->zona ndërmjet përroit të Gramës dhe përroit të Veleshicës

Për shkak të shtrirjes gjeografike më të madhe nga kostumet popullore të grave përhapjen më të gjerë e ka veshja e fshatrave në perëndim të luginës së Drinit të Zi. Kjo veshje përbëhet prej: rizës*, këmishës së gjatë prej pambuku, pështamallit*, xhamadanit pa mëngë, mbathje të gjata të bardha pambuku, brezi shumëngjyrësh, corape leshi, opingave prej lëkure lope me xhalma * leshi dhe xhupës* prej shajaku të bardhë të qëndisur mjeshtërisht në gjoks e në shpinë.

Veshja e grave të Lurës është pothuajse e njëjtë me atë të sipër përmendur. Ndryshimi është në motivin e qëndisjes së xhupës. Gratë katolike të Lurës qëndisnin në shpinë kryqin.

Veshje e grave të aristokracisë feudale të qytetit të Peshkopisë dhe Shehrit të Dibrës është krejtësisht e ndryshme nga ajo e trevave të tjera për shkak të ndikimit të lartë të kulturës osmane në zonë duke huazuar nga kjo e fundit disa elementë. Pjesë të kësaj veshje janë: sharpa*, fustani, mbathje të gjata që nuk duken, corape të gjata njëngjyreshe, papuce, këpucë dhe mantë*. Gratë e moshuara mbajnë sargia të zbukuruara në të katër anët me tufa.

Me vlera të vecanta artistike dhe kulturore janë edhe kostumet popullore të grave të Uji'e m'ujës, Gollobordës dhe padyshim ajo e krahinës së Zerqanit. Këto kostume kanë hyrë dhe zënë vend denjësisht në fondin e Kulturës Kombëtare Shqiptare.

Kostumet e burrave janë më të thjeshtë dhe ngjyrat e përdorura janë më të pakta. Mbizoterojnë ngjyra e bardhë, e zezë dhe e kuqe. Ato përbëhen prej qeleshes së bardhë, këmishës së bardhë prej pambuku, mëngët e së cilës janë të rudhura te kyçi i dorës, xhamadani, qisteku, brezi i punuar me ngjyra, tirqë dhe koprona deri poshtë belit. me një jakë të madhe që në kohë shiu modelohej në trajtën e kapucit.

Rizë -> shami e bardhë prej pambuku që shërben si mbulesë për kokën

Pështamalli -> përparëse

Xhalma -> lidhëse prej leshi që shërbejnë për lidhjen e opingave

Xhupa -> lloj jeleku grash

Sharpa -> mbulesë për kokën

Manta -> lloj palltoje

PRODHIMET ARTIZANALE

:janë shprehje e artit ,kulturës dhe mjeshtërisë popullore të trashëguara ndër shekuj nga njëri brez në tjetrin.Ndërkohë në vendet e zhvilluara këto pasuri janë zbehur si rezultat i modernizimit në mënyrën e jetesës,në shumë vende të tjera këto pasuri vazhdojnë të rruhen mjaft mirë edhe sot.Cdo vend ofron specifikat e veta në tregun turistik me prodhimet e tij artizanale në formën e suvenirëve të ndryshëm,të cilat tërheqin shumë turistë,me qëllim njohje dhe blerje të tyre.Prodhimet e artizanëve dibranë mund të bëhen pjesë integrale e lëvizjes turistike.Punimet dekorative prej druri,bakri dhe bronxi,instrumenta muzikorë tipike të zonës si fyelli dhe çiftelia,qilimat dhe sixhadet përbëjnë një pjesë të atij arsenali produktesh që mund të furnizojnë tregun e prodhimeve artizanale.

FOLKLORI DIBRAN

Folklori dibran është pasuruar vazhdimisht ndër shekuj.Motivet e jetës së përditshme,të punës,luftës dhe dashurisë shprehen këndshëm në këngët, vallet dhe lojrat popullore.Kjo pasuri është ruajtur me fanatizëm dhe trashëguar brez pas brezi,sidomos në malësinë e Dibrës ku "Oda e miqve" nuk mund të jetë e plotë pa çiftelinë e varur në mur.Një rol të pamohueshëm në transmetimin ,ruajtjen,intrepretimin dhe pasurimin e fondit artist të Dibrës ka luajtur dhe ansambli folklorik"Dibra",i ngritur në vitin 1947.Këngët karakteristike të kurbetit,këngët e dasmave, këngët epike dhe ato të dashurisë janë tashmë melodi autentike të muzikës dhe fondit muzikor shqiptar.Vallet tabanore që shquhen për ritëm,levizje dinamike,plasticiteti dhe karakteri epik janë vlerësuar në disa festivale ndërkombëtare ndër vite.

ODA DIBRANE

.Vitet e fundit djep i evidentimit t ë vlerave folklorike të zonës dhe më gjerë është bërë festivali folklorik"Oda Dibrane".Festivali është kthyer tashmë në një traditë të përvitshme ku marrin pjesë grupe folku nga Kosova,treva.t shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi.Gjithashtu marrin pjesë grupe nga Shqipëria veriore dhe verilindore.Këngët,vallet epike dhe humoristike,ritet,alegoritë dhe lojrat poullore të japin një ndjesi të paharrueshme.

Guzhina dibrane është epasur në lloje.produktet bujqësore dhe blegtorale vendase janë përbërësit bazë të gatimeve të zonës.kjo traditë gatimi ka rdhur duke u përmirësuar e pasuruar në lloje pa u larguar nga sjijet

dhe përbërësit tradicional..Restorantet vendase kanë filluar ti rikthehen traditës duke mundësuar ushqimet tradicionale për të huajt.Në Dibër dotë mundtë shijohen :flia,corba,koronajku,pula me jufka,pula me qepë,buka e norme(vale),djathi i dhisë,qengj në hell,petulla malësie ,birjanin e Peshkopisë etj.

FESTAT TRADICIONALE

Janë një tjetër shfaqje e pasurisë kulturore të rajonit. shumica e tyre janë festa pagane të cilat mbajnë gjallë traditat e vjetra të popullit. Gjatë viteve festat janë shtuar në numër dhe janë pasuruar me elemente të reja duke u rritur edhe më tepër vlerat. Këto festa shërbejnë për mbledjen e të gjithë trungut familjar dhe të afërmëve duke shërbyer si bazë për turizmin familjar.

POTENCIALI TURISTIK SEKONNDAR

Përvec elementeve primarë me shumë rëndësi për zhvillimin e turizmit janë edhe elemente dytësore por shumë të rëndësishme sic janë infrastruktura, popullsia dhe ekonomia. Në shumë raste potenciali natyror dhe kulturor mbetet i pashfrytëzuar për shkak të mungesës së infrastrukturës, mungesës së interesit nga ana e popullsisë dhe prapambetjes ekonomike.

INFRASTRUKTURA

Duhet parë me të gjithë elementet e saj në shërbim të turizmit. Rregullimi infrastrukturor duhet bërë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e turistëve. Në infrastrukturën e një zone përfshihen një sërë elementesh të cilat ndikojnë direkt apo indirekt edhe në zhvillimin turistik të zonës. Këtu përfshihen: rrjeti tregtar i zonës i cili i shërben edhe turizmit, rrjeti i shërbimeve, i transportit, telekomunikacionit, shërbimit shëndetësor, i furnizimit me energji dhe ujë, i largimit të mbeturinave, etj.

INFRASTRUKTURA RRUGORE

Dibra lidhet me kryeqytetin nëpërmjet aksit rrugor Peshkopi-Tiranë, 162km i gjatë, me Kukësin si dhe me Maqedoninë. Është e lidhur me rrugë rurale me të gjitha komunat. Në përgjithësi këto rrugë janë të paasfaltuara. Qarku i Dibrës dhe Bashkia Peshkopi në bashkëpunim me komunat e rrethit kanë ndërmarë projekte për rehabilitimin e rrjetit të rrugëve rurale. Ky rehabilitim do të përmirësojë dukshëm shërbimet dhe lidhjen e fshatrave me tregun gjithashtu edhe levizjen e turistëve në zonë.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i infrastrukturës së zonës është komunikimi dhe bashkëpunimi ndërkufitar. Rikonstruksioni i rrugës Maqëllarë-Bllatë dhe Maqëllarë-Peshkopi ka mundësuar një komunikim më të mirë ndërmjet Dibrës së vogël dhe Dibrës së madhe. Kjo rrugë mund të shërbejë edhe si pjesë e një itinerari ndërkufitar turistik. Ndërtimi i rrugës së re Peshkopi-Kukës është një tjetër mundësi për rritjen e lëvizjes turistike në rajon. Rruga kalon pranë fshatrave : Sllovë, Kala e Dodës, Radomirë të cilat

njihen për potencialet e tyre për zhvillimin e agroturizmit dhe turizmit në natyrë. Kjo rrugë mund të shërbejë gjithashtu për kalimin tranzit nga Kosova në drejtim të Strugës dhe Ohrit.

SHËRBIMI SHËNDETËSOR

I gjithë rrethi i Dibrës mbulohet më së miri nga sistemi shëndetësor i cili përbëhet nga shërbimi shëndetësor parësor, shërbimi spitalor dhe shërbimi farmaceutik. Ky shërbim sigurohet nëpërmjet qendrave shëndetësore dhe ambulancave. Ashtu sic është përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë cdo komunë e rrethit është e pajisur me nga një qendër shëndetësore. Secila prej tyre është e pajisur me një mjek të përgjithshëm i mbështetur nga infermierë dhe mami. Shërbimi shëndetësor në rrethin e Dibrës është në qendër të vëmendjes të organeve përkatëse të cilat kanë marrë masa për përmirësimin e mëtejshëm të tij.

RRJETI I SHËRBIMEVE

Duke analizuar këtë rrjet vihet re që ai mund të vihet në shërbim të turizmit kuptohet me përmirësim të mëtejshme. tregtia si pjesë e këtij rrjeti është tashmë e mirë formuar dhe në gjendje të ofrojë një gamë të gjerë produktesh. Tregu i produkteve bujqësore dhe blegtorale furnizon me produkte cilësore dhe të freskëta gjatë të gjithë vitit popullsinë vendase dhe ka prodhim të mjaftueshëm për të furnizuar me to edhe kërkesat e turistëve. Mjalti, arrat, mollët dhe një gamë e gjerë produktesh të tjera cilësore janë të mundshme të gjenden në rajon. Një sërë dyqanesh të tjera i ofrojnë popullatës një shërbim cilësor. Në ndihmë të qytetarëve të Peshkopisë dhe Dibrës dhe ngritjes së nivelit të shërbimit të shpejti do të hapet edhe një qendër tregtare në qytet. Telekomunikacioni është një element tjetër i rëndësishëm i sektorit të shërbimeve. që në rrethin tonë mendoj se është i zhvilluar si në qendra të tjera të vendit. Telefonia e lëvizshme mbulon cdo pikë të rrethit. gjithashtu në qytet dhe në shumicën e komunave gjenden edhe qendra që ofrojnë internet. Rrjeti bankar përbëhet nga filiale të bankave të ndryshme të cilat operojnë në vend dhe ofrojnë një shërbim të gjithanshëm dhe cilësor ndaj klientëve.

AKOMODIMI

Zona e Dibrës ofron mundësi edhe për akomodimin, që nga hotelte e pajisura me pajisje dhe shërbime bashkëkohore deri tek guesthouse-t, të cilat ofrojnë tradicionale. Këto njësi akomodimi ofrojnë një cilësi të mirë shërbimi dhe me restorantet e tyre shërbehet një shumëllojshmëri ushqimesh me bazë produktet vendase. Guesthouset janë përhapur së fundmi në rajon dhe kanë rezultuar të suksesshme në pritjen e një pjese të mirë të lëvizjes turistike të rajonit. Ato i japin mundësi vizitorëve të përjetojnë kulturën dhe mikpritjen që tradicionalisht ka karakterizuar rajonin tonë.

POPULLSIA

Roli i popullsisë në turizëm duhet parë si mbështetje për zhvillimin e tij dhe sinjë angazhim konkret i saj për të plotësuar nevojat e sektorit turistik me potencialin e nevojshëm njerëzor dhe ekonomik. Dibra është një rajon me popullsi vitale, e aftë për punë. Arsimimi i popullsisë së zonës është në parametra të kënaqshëm, duke bërë të mundur trajnimin më të lehtë të tyre për ti shërbyer sa më mirë sektorit turistik. Populli i Dibrës është punëdashës dhe këtë e dëshmon qartazi krijimi vreshtave pemëtoreve, fushat e mbjella me probukter bujqësore, tufat e mëdha të dhenve e dhive që kullosin në malet dhe kodrat e zonës, duke u bërë bazë mbështetëse për zhvillimin e turizmit.

TURIZMI AKTUAL NË DIBËR

Pavarësisht se Dibra nuk është futur në guidat apo destinacionet e tur-operatorëve të mëdhenj që operojnë në tregun turistik shqiptar ajo është vizituar nga një numër i konsiderueshëm turistësh. E vetmja pjesë e Dibrës që është bërë pjesë e lëvizjeve të organizuara turistike është Lura. Lura me magjinë që të krijojnë liqenet dhe bukuritë e tjera natyrore ka qënë pjesë e lëvizjes turistike prej kohësh në rajon. Kushdo që vjen në Dibër e ka të vështirë të largohet pa vizituar Lurën. Njerëz të rangjeve dhe profesioneve të ndryshme janë tërhequr prej magjisë së saj. Edit Durham e ka vlerësuar bukurinë e saj që në shekullin e nëntëmbëdhjetë : "Kur erdha në Lurë pashë një fushë të mrekullueshme që s'e kisha parë në asnjë vend të Ballkanit." Numri i turistëve që vizitojnë Lurën pavarësisht dëmtimeve të viteve të fundit rritet nga viti në vit. Ky numër në arrin deri në 5000 turistë në vit. Udhëtime për kalimin e fundjavës në Lurë organizohen nga disa kompani si FANI TRAVEL&TOUR, ONUFRI VOYAGE etj. Gjatë katër viteve të fundit në Peshkopi operon agjensia KORABI TRACKING&TOURS. Kjo agjensi operon me turistë anglezë, gjermanë, çekë dhe polakë të cilët janë të apasionuar pas turizmit të aventurës. Agjensia deklaron se numri i turistëve që ajo sjell në Dibër ka njohur rritje nga njëri vit në tjetrin. Ky numër varion nga 500 deri në 800 turistë në vit. Vlen për tu theksuar fakti se një pjesë e këtyre turistëve janë kthyer vitin pasardhës ose kanë shprehur dëshirën të kthehen sërish. Kjo agjensi shprehet se si strehim për turistët kanë shërbyer guest house-t dhe shtëpitë e fshatarëve të zonës së Korabit. Mënyrë tjetër akomodimi kanë qënë stanet e barinjve në bjeshkët e Gramës dhe Deshatit si dhe kampingjet e përkohshme.

Peshën më të madhe të lëvizjes turistike në rajon e zë turizmi kurativ. Qendra balneare e Peshkopisë frekuentohet nga rreth 6000 veta në vit për kurime ditore dhe nga rreth 300 veta për kuime dy-javore. Pushues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe trevat shqiptare jashtë vendit, Maqedonia dhe Kosova janë pjesa përbërëse e kësaj lëvizje turistike në rajon. Turizmi kurativ është bërë nxitës i ngritjes të një sërë hotelesh në zonë duke rritur kështu konkurrencën për përimrësimin e shërbimit.

LLOJET E TURIZMIT QË MUND TË ZHVILLOHEN

Meqënëse turizmi është një fenomen mjaft i gjerë janë shumë të larmishme motivet, llojet dhe format e shfaqjes së tij. Një tendencë në rritje është ndarja e tregjeve turisike me më shumë turistë të cilët kërkojnë një pjesëmarrje aktive në aktivitetet dhe rekreative dhe sportive. Ata kërkojnë të mësojnë të përfshihen në kulturën lokale, kërkojnë destinacione të reja dhe të zhvillojnë interesa të vecanta nëpërmjet udhëtimit. duke u nisur nga këto prirje të reja të turizmit si dhe nga çfarë mund të ofrojë Dibra mendoj se këto forma dhe lloje të lëvizjes turisike mund të zhvillohen dhe të zgjerohen në rajon.

Politikat dhe strategjia kombëtare e turizmit reflekton vizionin e drejtimit strategjik për zhvillim. Sipas kësaj strategjie qëllimi i zhvillimit të turizmit shqipëtar është që të rrisë cilësinë e jetës për shqipëtarët duke theksuar zhvillimin e formave të ndryshme të turizmit. Qarku i Dibrës dhe njësitë vendore të qeverisjes kanë hartuar strategjitë e tyre duke u bazuar në SKZHI. Në bazë të këtyre strategjive është mbrojtja e mjedisit dhe kulturës si faktor primar i zhvillimit turistik.

1- TURIZMI BALNEAR LIQENOR DHE LUMOR.

Në ditët e sotme po shfaqet turizmi balnear liqenor i cili lidhet jo vetëm me disa karakteristika dalluese të liqeneve si: shtrirja, pozita gjeografike, origjina uji i ëmbël, por edhe mëpëraftrimin kulturor të njerëzve banojnë pranë tyre. Liqenet e lurës dhe të Kacnisë janë një destinacion i mrekullueshëm ku mund të ndërthuren natyrshëm gjithë sa thamë më lart.

Ujrat e Drinit të Zi, peizazhi rërheqës i luginës së tij si dhe komplekset sportive që kanë filluar të ndërtohen përgjatë brigjeve të tij e bëjnë atë një pikë të këndshme pushimi.

TURIZMI I BARDHE

Perben llojin e dytë më masiv të lëvizjes turistike pas atij balnear. Zhvillohet në pjesët larta të maleve me kushte të përshtatshme të relievit, shtresës së dëborës dhe qëndrueshmërisë së saj. Sic e theksuam dhe trajtuam tek oferta gjeografiko-natyrore rajoni i dibrës ofron kushte të përshtatshme të formave të relievit dhe ditëve meshtresë të qëndrueshme të borës për zhvillimin e turizmit të bardhë. Investimet e duhura në këtë drejtim do ta kthenin Dibrën në një qendër të mirëfilltë të kësaj pjese të rëndësishme të lëvizjes turistike.

TURIZMI SPORTIV DHE AI I AVENTURËS

Oferta e pasur në larminë e formave të natyrës i japin rajonit një vlerë të pakrahasueshme për zhvillimin e formave të larmishme të turizmit sportiv dhe atij të aventurës. Gjithmonë e më tepër turizmi i aventurës po bëhet një pjesë e rëndësishme e formave dhe menyrave të zbavitjes dhe argëtimit. Vargu i Korabit, Maja e Runjës, Parku kombëtar i Lurës, Bjeshkët e Gramës dhe të Deshatit, Gryka e Setës dhe numri i madh i shpellave i japin mundësinë kujtdo të përjetojnë eksperiencë të paharrueshme.

Sporte të tilla si: alpinizmi, gjuetia, rafting, speleologjia, kalërimi, ngjitjet me bicikleta dhe motocikleta peshkimi janë vetëm një pjesë e aktiviteteve që mund të zhvillohen.

TURIZMI KULTUROR

Turizmi kulturor mund të jetë një segment i rëndësishëm i sektorit të turizmit në Dibër. Kjo formë e lëvizjes turistike mund të njohë një zhvillim të qëndrueshëm në rajon pasi ai mund të përfitojë nga folklori i vecantë, stili i jetesës, trashëgimia kulturore, produktet artizanale, gastronomia dhe potenciali krijues. Duhet kuptuar që turistët që vizitojnë zonën kërkojnë një përvojë jo domosdoshmërisht luksoze, por të vecantë. Pikërisht këtë mund ta ofrojë dibra me folklorin e saj (kengët dhe vallet tradicionale), prodhimet artizanale, kostumet popullore etj. Investimi në përmirësimin e mënyrës së servirjes tek turistët të gjithë kësaj pasurie etnokulturore do të rriste numrin e tyre në rajon.

TURIZMI RURAL.

Turizmi rural ka në bazë të zhvillimit të tij motivet që ishtyjnë njerëzit për të përjetuar atmosferën e fshatit me natyrën e bukur dhe të qetë dhe me prodhimet e ndryshme bujqësore dhe blegtorale. Si formë e re e turizmit ai ndikon në diaspora drejtime:

-Zbut krizën e bujqësisë nëpërmjet rivlerësimit të saj, duke rritur të ardhurat, duke organizuar territorin, duke cmuar prodhimin e konsumin bujqësor që krijon një treg të mirëfilltë turistik me një shumëfishim të ardhurave

-Vë në kontakt banorët e qytetit me ata të fshatit, me jetën, ndërtimet, peizazhin rural, pasuritë kulturore-folklorike etj, duke i afruar më shumë ata nga pikëpamja sociale

-Turizmi rural mund të zbusë deri diku edhe krizën e papunësisë

-Organizimi dhe praktikimi i tij gjatë gjithë vitit, por sidomos në stinën e verës, përbën një alternativë dhe mundësi të madhe të riekulibrimit territorial, ekonomik e social, pasi zbut mbingarkesat turistike sezonale të palzheve, të cilat nga pikëpamja rajonale janë shumë të dukshme

-Turizmi rural duke qënë gjithëvjeter dhe i larmishëm zgjeron strukturën e ofertës dhe konsumit turistik si dhe krizën e sezonalitetit të turizmit në përgjithësi

Në kohët e sotme rëndësia e tij shtohet edhe për arsye të "shpërthimit" urbanistik problematik,ku fshati dhe peizazhi rural ne përgjithësi konsiderohen nga kjo pikëpamje si "oazë" qetësie natyraliteti dhe clodhje.Turizmi rural mund të kthehet në një formë të rëndësishme të lëvizjes turistike në Dibër. Oferta rurale e Dibrës e përbërë nga peizazhi rural natyror ose i humanizuar,jeta bujqësore dhe prodhinet e saj,blektoria dhe përpunimi i produkteve të saj në forma tradicionale folklori dhe mikëpritja janë një pjesë e elementeve që zgjerojnë ofertën për zhvillimin e turizmit rural. Numri i madh i fshatrave shumica e të cilave e ka ruajtur me fanatizëm traditën janë një burim i mirë për ti dhënë mundësi zhvillimi kësaj lëvizje.Shtrirja e tyre në pjesë të ndryshme të relievit u jep mundësinë turistëve të përjetojnë edhe lloje të ndryshme aktivitete.Fshatra të tillësi:Radomira,KalajaeDodës,Selishta,Qafë Murra,Muhuri,Arrasi,etj.janë bërë tashmë pjesë e kësaj lloj lëvizjeje në rajon.

TURIZMI KURATIV

Bazohet në vlerat kurative që paraqesin vende të caktuara turistike të botës.Ka plot njerëz në botë që kanë nevojë të marrin pjesë në këtë lloj të lëvizjes turistike me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre apoku kanë probleme në këtë drejtim.Kjo lloj lëvizje turistike drejtohet so drejt qendrave klimaterike natyrore asht edhe drejt ujrave termale me vecori specifike kuruese.Ky lloj turizmi bazohet në vlera të vecamta të ujrave minerale dhe termominerale ku temperatura e ujit të banjave lëviz nga 20-95°C dhe së bashku me përbërjen kimike të ujrave minerale ndihmon në shërimin e shumë sëmundjeve.Turizmi kurativ në këtë moment është forma kryesore e lëvizjes turistike në rajon.Turizmi kurativ mund të zgjerohet edhe më tepër nëqoftëse do të bëhej një investim dhe promovim me i mirë.

PËRMIRËSIMI I PRODUKTEVE TURISTIKE

Produkti I turizmit sapo ka filluar te zhvillohet ne rrethin e Dibres .Lura eshte tashme nje pjese e rendesishme e structures turstike te rrethit .Keto vitet e fundit Korabi ,Mali i Deshatit ,Mali i Grames i Runjes ,Lugina e Drinit te Zi po shndërohen në pika të turizmit natyror dhe argetues .Ne rajon nje numer gjithnje e ne rritje shtepish po aplikojne formatin e nje guest house duke ofruar sherbime turistike per vizitoret .Keto produkte jane rritur ne menyre "individuale",te padrejuara nga nje strategji zhvillimi produktesh apo marketing.produktet qe tashme terheqin turiste duhen cuar me tej ne te ardhmen dhe te tregtohen fuqishem duke ofruar sherbime ekzistuese te permiresuara dhe pse jo dhe sherbime luksi .Nje game e gjere ambjentesh dhe aktivitete duhet te zhvillohet ne menyre qe te mbaje klientet sa me gjate ne rajon .Menaxhimi i duhur i burimeve ekzistuese duhet te siguroje zhvillimin ne menyre te kontrolluar te levizjes turistike por edhe te mjedisit ,kulurës dhe shoqërisë .

Zhvillimi I produkteve të përgjithshme

a.KRIJIMI I QENDRAVE TË INFORMACIONIT PËR TURISTË (QIT)

Një element i rëndësishëm i ofertës së një vendi për të mirëpritur turistë është sigurimi i informacionit për orientimin në rajon .Për të realizuar sa më mirë këtë element duhet të ngrihet një system i mirë qendrash informacioni për turistët,të cilat duhet të jenë të lehta për tu përdorur .Që të kryejnë sa më mirë funksionin e tyre si pika kryesore e orientimit për vizitorët ato duhet të jenë të pajisura në mënyrë moderne .Duhet që të ofrojnë salla për shfaqjen e programeve informative për zonën ,sportele informacioni ,salle pritjeje ,dyqane suveniresh etj .Qendra e informacionit duhet të ndërtohet në një vend të dukshëm .

b.SINJALISTIKA

Në rrethin e Dibrës ka mungesë të theksuar sinjalistike drejtuese për ne atraksionet turistike prandaj do të ishte më se e nevojshme vendosja e tabelave drejtuese .Këto tabela duhet të vendosen sipas kriterëve ndërkombëtare si :

Tabela të vendoset në një distancë të mjaftueshme larg kthesës për në destinacion që të mund të vihet re ,të kuptohet mirë dhe udhëtarët të mos humbasin kthesën.Një tabelë dytë duhet të vihet direct tek kthesa e rrugës .

Tabela duhet të jetë e qartë dhe në madhësi të mjaftueshme për tu vënë re .Ajo duhet të jetë me ngjyra të njohura në nivel ndërkombëtar dhe në dy gjuhë,shqip dhe anglisht.

Si referim për ndërtimin e sinjalistikës duhet përdorur sinjalistika ndërkombëtare e nxjerrë në një publikim të UNWTO

C.PIKAT E VROJTIMIT

Me rëndësi të vecantë është fakti I nxjerrjs në pah të pamjve madhështore të cdo pike të rrethit prandaj është e nevojshme ndërtimi I pikave të vrojtimit .Ato mund të ndërtohen në pjesë të ndryshme të sistemit rrugor,në anë të rrugëve duke niveluar dhe shtruar me zhavor një pjesë rruge ku mund të parkohet dhe panorama që shfaqet të jetë me të vërtetë mbreslënëse .Pikat e vrojtimit mund të ngrihen gjatë gjithë zonës madje mund të vendoset edhe nje tabelë që shpjegon çfarë mund të shihet dhe emrin e atraksionit.

d.SHTIGJET MALORE

Relievi në përgjithësi malor I bën shëtitjet dhe ngjitjet në mal aktivitete dominuese për turistët vecanërisht në vargun e Korabit ,Balgajjt ,Deshatit ,Gramës etj.Për të masivizuar këto aktivitete ndërtimi I shtigjeve

malore është një domosdoshmëri .Shtigjet duhet të jenë natyrore duke mënjanuar sa me shumë prishjen e bimësisë dhe tokës .Krijimi i nje shtegu lidhës ndërmjet parkut kombëtar të Lurës me Runjën e Lurës ,Grykën e Setës dhe Runjës së Peshkopisë do të krijonte konceptin e itinerareve rrethore si rezultat do të ketë një numër më të madh turistësh që do të vizitojnë luginën e Drinit të zi dhe malet rreth saj si dhe do të përdorin guest house –at dhe shërbimet e ofruara nga vendasit .

e.KAMPINGJET

Sic e theksuam më lart sektori I turizmit është në hapat e para prandaj edhe mundësia për akomodim është e kufizuar .Ndërtimi I kampingjeve do të ishte një mundësi e mire për akomodimin e turistëve .Kampingje mund të ndërtohen në të gjitha pikat e relievit pasi plotësohen kushtet ndërkombëtare për ngritjen e tyre sic janë :prezenca e një burimi ujqor jo më larg se 50 m ,mbajtja e kafshëve si kuaj apo mushka në përdorim, popullsi vendase e afert etj .

f.PIKAT E PESHKIMIT

Pasuritë hidrografike të rrethit mundësojnë peshkimin në liqene ,lumenj e përrenj.Këto burime ende nuk po përdoren te paktën për arsye turizmi .ujërat e Drinit të Zi ,Stës, Liqeneve të Lurës dhe rezervuareve ujore të ndërtuara nga njeriu mund ta kthejnë peshkimin në një produkt cilësor në rajon .

ZHVILLIMI I PRODUKTEVE SPECIFIKE:

a)ATRAKSIONNET KULTURORE

Duhet të vihen po aq në qendër të vëmendjes sa edhe ato natyrore.Njësitë vendore të qeverisjes duhet të punojnë më shumë në këtë drejtim.Përmirësimi I objekteve me vlera historike dhe kulturore duhet të fillojnë me rikonstruktimin e këtyre objekteve pranë cdo komune.Rikonstruktimi dhe vënia në përdorim e muzeut të Skënderbeut në fshatin Sine të komunës Arras do t'ia shtonte edhe më tepër vlerat turistike kësaj të fundit.Cdo njësi vendore duhet të ndërtojë një muze të vogël ku të pasqyrohet e gjithë historia dhe kultura vendase.

b)INFRASTRUKTURA

Përmirësimet e infrastrukturës së përgjithshme të tilla si përmirësimi i rrugëve,energjisë elektrike,ujit dhe sistemeve të komunikimit në rrethin e Dibrës janë në zhvillim nga agjensitë përkatëse të sektorit publik,por kjo duhet të kryhet me hapa më të shpejtë dhe në mënyrë sa më cilësore pasi kjo infrastrukturë është baza për zhvillimin e turizmit.Një sipërmarje e madhe e infrastrukturës që do të kishte një ndikim të madh në zhvillimin e Dibrës është ndërtimi i rrugës së Arbrit dhe rrugës Mat-Selishtë-Peshkopi.

c)STRATEGJIA E MARKETINGUT

Qarku I Dibrës,bashkia Peshkopi dhe të gjitha njësitë vendore kanë përcaktuar turizmin si mundësi zhvillimi në strategjitë e tyre.Asnjëra prej tyre nuk e ka parashikuar marketingue e turizmit në këto strategji prandaj mendoj se një strategji marketingu e mirëstudiuar duhet të hatrohet dhe të zbatohet.Një strategji e tillë do të konsolidojë tregun eksistues dhe do të sigurojë kushtet për të tërhequr turistë të rinj.Dy janë teknikat bazë në hartimin e saj:

-segmentimi i tregut dhe identifikimi i tregjeve të synuara

-vendndodhja e destinacionit dhe marka

Përcaktimi I tregjeve të synuara dhe zhvillimi i produkteve për një destinacion janë detyra të ndërlidhura për shkak të natyrës statike të produktit turistik.Për të tërhequr tregun e duhur dhe kombinimin e produkteve që ofron destinacioni strategjia e marketingut duhet të fokusohet në identifikimin e vizitorëve potencialë me karakteristika të ngjashme dhe në krijimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të përshtatshme për të plotësuar kërkesat dhe nevojat e tyre.Detyra e dytë kryesore e strategjisë është pozicionimi I rrethit të Dibrës si destinacion dhe gjetja e një identiteti unik dhe lehtësisht I dallueshëm.Si fillim tregjet e mëposhtme do të ishin tregu I synuar më I përshtatshëm.

TREGU VENDAS.

Tirana dhe Durresi dhe qytete te tjera shqiptare mund te jene treg potencial vendas.Këtyre qendrave urbane u duhet dhënë përparësi për shkak të numrit të madh të vizitorëve të mundshëm ,vecanërisht tregu aktiv i vizitorëve që do të donin të shijonin natyren e bjeshkëve në Dibër .Marketingu në këtë rast përfshin punën me operatorët turistike ne qytetet përkatëse për përfshirjen e Dibrës në paketat e tyre.

TREGU TRANSIT

Rrethi I Dibres me ndërtimin e rrugës se Arbrit do të shërbente si rrugë transit mes Maqedonisë ,Tiranës dhe bregdetit shqiptar.Strategjitë duhen përshtatur për të inkurajuar tregun transit të ndalojë në rajon gjatë rrugës duke rritur shpenzimet e tyre në restorante dhe locale si dhe në blerjen e produkteve vendase .

SHQIPTARET NGA VENDET FQINJE

Festivali Oda Dibrane është një mundësi e mirë për zgjerimin e tregut turistik me shqiptarë nga vendet fqinje.Një promovim më i mirë i këtij eventi do të krijonte një rritje të numrit të grupeve pjesëmarrëse kohëzgjatjen dhe rritjen e numrit të shikuesve .

-TREGU NDËRKOMBËTAR:

Ky treg është relativisht I vogël,por vlerësohet se gjatë dy-tre viteve të fundit ka ardhur në rritje.Operatorët e paktë turistikë qe sjellin turistë ndërkombëtarë në Dibër janë mjaft aktivë,por ato kanë nevojë për ndihmën e qeverisjes vendore për të zgjeruar dhe përmirësuar cilësinë e ofertve të tyre.Rruga e Arbrit do të krijonte mundësinë që ky treg të zgjerohej pasi shkurton dukshëm distancën ndërmjet aeroportit dhe bregdetit me Dibrën.

-TREGU I EMIGRAN **ËN MEDIASPOR** **ËS**

Ky treg është më lehtë i arritshëm pasi atyre u interesojnë aktivitetet e zhvlluara në vendin e origjinës.Shumica e emigrantëve të cilët jetojnë ne Britani, Itali, Gjermani, Francë, SHBA,etj. e kanë kthyer vëmendjen e tyre në kalimin e pushimeve në atdhe.Ato mund të shihen edhe si një potencial i mirë për të investuar në infrastrukturën turistike në rajon,gjithashtu emigrantët duhet të përdoren për të promovuar Dibrën tek miqtë e tyre në vendet ku jetojnë dhe madje të krijojnë agjesni turistike për sjelljen e turistëve në Dibër.

-DESTINACIONI DHE MARKA

Për të shfrytëzuar sa më mirë ofertën turistike dhe rritjen e turizmit rrethi i Dibrës duhet të pozicionohet në tregun shqiptar,rajonal dhe global.Ai duhet të pajiset gjithashtu me një markë të përshtatshme.Pozicionimi dhe marka janë dy koncepte të ndryshme.Marka është imazhi që krijohet kur një person përballet me një produkt ndërsa pozicionimi tregon se si ky produkt krahasohet me konkurrencën dhe ka si objektiv krijimin e një vendi të vecantë në mendjet e klientëve potencialë.

-INSTRUMENTAT DHE TEKNIKAT E MARKETINGUT

Për të aritur një marketing sa më të suksesshëm për të tregtuar dhe promovuar turizmin në rreth mund të përdoren teknika të ndryshme si:

Reklamimi ne media	Reklamimim konsumator dhe tregtar: TV, shtypi (revistat dhe gazetatat),radio.poster,reklammat në ambient të hapur,pika shitjeje etj
Kolateral për kanalet e identifikuara të shpërndarjës	Koletaral konsumator dhe tregtar :broshura, video,CD,DVD
Paketë dhuratë	Suvenirë për prezantim te tour operatorët dhe VIP-at
Pjesemarja në panaire dhe ekspozita tregtare e konsumatore	Panaire tregtare,konsumatorësh,seminare.
Marketing I drejtpërdrejtë	Me postë ose e-mail kontakteve të medias ose tregtare
Aktivitete të vecanta	Organizimi I aktiviteteve të vecanta
Aktivitete PR (mardhënie me publikun)	Njoftim për shtyp, konferenca fjalime në public, promovime nga njerëz të famshëm etj
Udhëtimet familjarizuese	Organizimi I udhëtimeve në rajon duke ftuar tour operatorë,gazetarë,media të ndryshme,operatorë me interesa të vecanta.
Qendrat e informacioneve për turistë/njësi për ekspozimin e broshurave	Vendndodhje konvencionale që ofrojnë informacion për vizitorët duke shpjeguar ose nëpërmjet hrtave,udhëzuesve, fletushkave informuese.
Promovimet tregtare dhe konsumatore	Aktivitete shitjesh dhe promovime në qendra tregtare.
Ëëbsite dhe e-marketing	Ëëbsite –I destinacionit pra marketing I drejtpërdrejtë elektronik
Kërkime dhe vlerësime	Kërkim tregu,kërkim produktesh, monitorim dhe kërkime vlerësuese.

Te gjitha sa thame me siper do te behen me te lehta per tu vene ne praktike ne qofte se ne Diber do te ngrihej nje OMD e cila do te ndihmonte koordinimin e strategjive dhe monitorimin e sektorit te turizmit .

PERFUNDIME

Nga analiza e bërë në këtë punim mund të arrijmë në disa përfundime që janë:

-Dibra mund të shndërrohet në një destinacion pasi ka një potencial turistik të favorshëm për zhillimin e disa formave të turizmit.

-Ka ofertë të pasur natyrore dhe kulturore.


-aktualisht ka një rritje të numrit të turistëve



REKOMANDIME

Në analizën e zhvilluar mbi mundësite që ofron rrethi i Dibrës mendoj se në të ardhmen do të ketë mundësinë të zhvillojë turizmin në mënyrë të tillë që sjellë të ardhura të konsiderueshme për ekonominë vendase. Për ta realizuar këtë duhet:

- † Një bashkëveprim i ngushtë i të gjithë aktorëve të cilët krijojnë kushtet e duhura infrastrukturore për zhvillimin e turizmit.
- † Hartimi dhe ndjekja me përpikmëri e planeve dhe strategjive për fushën e turizmit dhe fushave të tjera të lidhura më të.
- † Cdo njësi vendore të përpiqet për mbrojtjen e pasurive natyrore dhe kulturore në hapësirën e tyre.
- † Ngritja e kapaciteteve turistike për cdo njësi vendore duhet bërë për cdo resurs turistik.
- † Ndërgjegjësimi i komunitet vendas mbi përfitimet që sjell zhvillimi i turizmit në rajon.
- † Trajnimi i atyre segmenteve të popullsisë që janë të implikuara në përbërjen e turistëve
- † Mrojtja e mjedisit natyror dhe kulturor.



BIBLIOGRAFIA

1. *DH . Doka , B . Draci : Gjeografia e turizmit*
2. *V . Koja , K.Gorica : Marketingu i turizmit , albPAPER , TIRANE 2007*
3. *Gjeografia fizike e Shqipërisë*
4. *ALCDF*

Sitography

1. *Statistic data from INSTAT <http://www.instat.gov.al/>*
2. *<http://www.mtkrs.gov.al/>*

